

NJËSITË MËSIMORE MODEL

LIBRI I DYTË

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 1

Paqeruajtsit në Komunitet

“Thirrja e Hagës për Paqe mbështet iniciativa për të njojtur rolin e femijëve dhe të rinjve si paqeruajtës.”

Axhenda e Hagës , rekomandimi 7 fq 19

PAQËRUAJTSIT NË KOMUNITET

Femijët e vegjël mund të ndihmohen për të kuptuar që Paqja dhe kultura e Paqes do të vijnë si rrjedhojë e punës individuale dhe grupeve të ndryshme që së bashku zhvillojnë kulturën e paqes në saj të punës personale dhe të bashkepunimit. Shoqëria civile, burimi i ditarit të Hagës, është krijuar nga këto individë dhe grupe. Pjesa e më poshtme e aktiviteve është marrë dhe adoptuar nga New York duke u bazuar në “Programin kreativ të zgjidhjes së konflikteve” si një mjet ndihmës në fillimin e zhvillimit dhe të të kuptuarit të këtij procesi dhe kësaj kulture. Këto leksione shërbejnë si ndihmë për femijët e moshës 9 – 10 vjec.

Marrë nga ; Ray, Peggy, Sheila Alson, Linda Lantieri & Tom Rodenick, *Të zgjidhësh konfliktet me kreativitet*, pjesë e bordit të edukimit të qytetit të New York dhe mësuesit e Përgjegjësisë Sociale në Qendrën Metropolitane. 1996, fq 57- 58.

Mosha dhe Subjekti : Shkolla fillore, studime sociale, art.

Materialet : Letra të bardha dhe lapsa me ngjyrë për të bërë lista dhe varur në mur.

Metoda : Hedhja e ideve fillestare, intervista, diskutime, vrojtime, vlerësime, lexim historish, dhe tregime historish.

Concepti : Procesi i ruajtjes së Paqes dhe Paqeruajtsit

Objektiva : Studentet duhet të jenë të aftë të ;

- **Të kuptojnw që ruajta e Paqes fillon me një impenjim personal**

- Të shikojnë që ka shumë mundësi dhe në jetën e përditshme të bëhet një paqëruajtës ashtu si edhe në situata të vecanta.
- Të vlerësojnë ngjarje dhe ndodhi për të identifikuar procesin e ruajtjes së Paqes dhe Paqeruajtsit.

Mënyra ;

1. Që femijët do të intervistojnë një të rritur në lidhje me procesin e paqes dhe ruajtjen e saj.
2. Hedhja e ideve për llojin e pyetjeve dhe ti shkruaj ato në fletat e bardha, ose në dërrasën e zezë.

Disa pyetje mund të jenë:

- Çfarë kuptoni ju me fjalën Paqe?
 - Na tregoni një rast në të cilin ju keni pasur një eksperiencë të tillë. Ku ishit? Çfarë po bënit? Me kë ishit?
 - Kur keni qënë ruajtës të paqes? Çfarë ka ndodhur? Sa njerëz të tjerë ishin në këtë histori? Si dolët nga ajo ngjarje?
 - A ka ndonjë arsye për të cilën ju mendoni se nuk jeni një paqëruajtës?
 - Kush janë 1 ose 2 persona të cilët të kanë betur në mendje si paqëruajtës? Përse ju zgjodhët ata?
3. Krijoni një model interviste duke intervistuar një nxënës. Përdorni pyetjen që nxënësit i gjetën vetë gjatë bisedës. Përdorni dhe këto të mësipërmet nëqoftëse është nevoja.
 4. Ftoni dikë në klasë nga komuniteti përreth shkollës të cilin nxënësit mund ta intervistojnë.
 5. Duke përfunduar; Pyesni nxënësit për të identifikuar dikë që ata njohin dhe e cilësojnë si paqëruajtës. I pyesni se çfarë personi ka bërë apo po bënë që ato e konsiderojnë si paqëruajtës. Pse besojnë se këto veprime të bëjnë paqëruajtës. Bëni një listë me “Paqëruajtësit tane” dhe e varni atë në klasë.

Aktivitetet shtesë

- Të marrësh intervista paqëruajtësve në shkollë.

- Flisni dhe diskutoni mbi paqëruajtesit në shkollë. Cilët njerëz rreth shkollës sillen si të tillë? A janë ata vetëm të rritur apo dhe të rinjtë ndonjëherë veprojnë si të tillë? Jep shembuj me njerëz që veprojnë si të tillë në shkollë, në klasë, në lagje, në qytet apo në botë.
- Krijoni një listë “Të ruajmë Paqen”. Rreshtoni disa sjellje dhe veprime që kontribuojnë në paqen e zonës ku jetojmë. Vare këtë listë jashtë klasës ose vendose për ta parë për të gjithë shkollën.

Paqëruajtësit në komunitet

- Zhvillo një pyetësor me klasën. Cakto një grup nxënësish të intervistojnë njerëz afër mjedisit shkollor për rastet që ato kanë qënë paqëruajtës. Në fund këto grupe mund të intervistojnë njëri tjetrin.
- Intervistoni njerëz të tjerë rreth paqes. Nxënësit duhet të përdorin pyetësorin për të intervistuar dikë më moshën e prindërvë të tyre dhe dikë më moshë më të madhe.
- Libri i paqes. Vendos së bashku në një libër gjithë fotografitë e bëra, intervistat dhe gjithçka tjetër sipas rradhitjes që nxënësve u pelqen.

Sugjerime për punën!

Gazeta: A e përdorin nxënësit gazetën e tyre për të shkruajtur rastet kur ndokush është sjellë si paqëruajtës ose kur ata vënë re dikë në jetën e tyre të sillet si i tillë?

Qytetarë të famshëm si shembuj paqëruajtësish: Njohja e njerëzve të njohur të qytetit është pjesë e këtij aktiviteti në shumë vende. Ju mund ti përdorni këto raste duke pyetur veten dhe shokët se në cilat raste ky person është sjellë si paqëruajtës dhe në cilat jo?

Biografitë e paqëruajtësve: Kontrolloni bibliotekën e shkollës ose bibliotekën e qytetit për të gjetur bibliografi të paqëruajtësve. Ju mund ta ndani klasën në disa grupe dhe tu kërkoni atyre që secili grup të bëjë kërkime rreth një paqëruajtësi dhe ti sjelli ato në klasë më vonë. Ose mund të fokusoheni rreth një personazhi të madh të famshëm duke i thënë nxënësve se secili grup duhet të studiojë një pjesë të jetës së tij.

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 2
Heroinat dhe heronjtë e paqes
Shkolla fillore

*Thirja e Hagës për paqe mbështet iniciativat për zëvendësimin e lavdeve për luftën
me modelet e të vepruarit në paqe.*

Akhenda e Hagës, Rekomandime 9, fq 21.

Një pjesë e rëndësishme e kulturës për paqe është që njerzit të veprojnë në paqe dhe pa dhunë. Kultura të ndryshme kanë heronjtë e tyre ne bazë të vlerave më domethënëse për ta. Në një kulturë dhune heroin e gjejmë midis luftëtarëve dhe pushtuesve. Në një kulturë paqeje heroi është ai që është përpjekur për “jo dhunën” dhe ndryshimet sociale pozitive. Sugjerojmë që ky leksion të filloj me një diskutim pse paqëruajtësit janë kaq të rëndësishëm për jetët tona dhe vendin tonë. Materiali që do të përdorni tani është shkruajtur në Zelandën e Re.

Marrë nga; Fondacioni i studimeve për paqen në Zelandën e Re, “*Marrëdhënien në paqe që ekzistojnë*” Një grup aktivitetesh për klasa dhe grupe për shkollën 8 vjecare, moshë 11 – 14 vjec Aucland, 1986, fq 38.

Mosha dhe Subjekti: E rekomandushme për klasat 6-9 që studiojnë shkenca sociale ose art. Mund të përdoret dhe për ndërtimin e një komuniteti brenda klasës.

Materialialet: Libra dhe video për fëmijë në të cilat gjejmë shembuj jo dhune dhe lidera paqeje.

Metoda: Duke lexuar, parë filma, duke diskutuar dhe në ndërtimin e situatave të ngjashme duke luajtur rolet e personave që analizoni.

Koncepti: Jo dhunë, drejtësi, hero-heroinë, përgjegjësi sociale.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që:

- Të tregojnë se si heronjtë dhe heroinat reflektojnë një kulturë të caktuar.
- Të identifikojnë njerëz të cilët demostrojnë se jetojnë në një kulturë paqeje.

Mënyra;

Ky është një ushtrim që fokusohet në jetën e personave të cilët e kanë gjetur veten në një konflikt dhe pastaj janë përkushtuar një fushate për paqeje për ndryshim dhe zgjidhjeje të problemeve.

1. Mahatma Gandhi, Dr Martin Luter King, Jr., Princess te Pua, Edith Cavell Rosa Parks, Dame Whina Cooper, Bob Geldof, Peshkopi Ocsar Romero, Joan Baez, Karen SilkWood, Te

Whitio-Rongomai. U thoni nxënësve se ç'ka bërë secili nga këto për paqen. U thoni nxënësve ta shtojnë këtë list dhe të japin arsyet e tyre pse i shtuan ato emra

2. Zgjidhni një emër nga lista e aktivistëve të mëposhtëm dhe gjeni:

- Kur ka jetur ky person? Nqs nuk është akoma gjallë.
- Me cilat probleme ata janë hasur në jetën e tyre?
- Çfarë ose kush i nxiti ata në këtë rrugë?
- Cili ka qënë rezultati i qëndrimit të tyre?
- Çfarë taktikash kanë përdorur në realizimin e fushatës së tyre?
- Jep vlerësimin tënd për suksesin e arritur nga ata?

(Nëqoftëse dëshironi klasa mund të ndahet në grupe të vogla nga 2-3 veta dhe pastaj secili grup të paraqes një raport të vogël në diskutimin final.)

3. Pyesni në klasë që t'ju flasin rreth heronjve dhe heroinave që ndodhen ne komunitetin e tyre ose që ata kanë pasur fatin të njohin. A ka në shkollën tuaj ndonjë të tillë ? Si mund ti nderojmë ne ata për punën që kanë bërë ?

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 3

Studimi i Dhunës

Cikli I lartë, shkolla 8 vjecare

“Eshhtë e zakonshme të mendojmë por kur nuk është provuar më parë që dhuna dhe mirqënia janë të lidhura ngushtë me mendjen humane. Në fakt shumë kultura të ndryshme mendojnë që të veprosh në paqeëshhtë mënyra më e mirë për të ndryshuar shoqërinë civile”

Për të kuptuar më shumë për paqen dhe se si ne mund ta zhvillojmë më shumë atë nxënësit në fillim duhet të kuptojnë kulturën e luftës dhe ka ndikuar ajo në jetët tona. Ky leksion mund të filloj me një diskutim se si lufta dhe dhuna dëmtojnë dhe terrorizojnë njerëzit dhe pse ne duhet ti eliminojmë ato. Dhe për të arritur deri këtu ne në fillim duhet të zhvillojmë kulturën e paqes. Ky

leksion është marrë nga Zelanda e Re dhe është një mënyrë për të zhvilluar aftësi të nxënësve për të kuptuar këto probleme.

Marrë nga: Fondacioni mbi studimet për paqen në Zelandën e Re.”Të zhvillojmë marrëdhëniet në paqe” Një pjesë për aktivitete për klasa dhe grupe nxënësish në ciklin e lartë të shkollës 8 vjecare. Mosha 11 – 14 vjec, 1986, Aucland, fq 38.

Mosha dhe Subjekti : E përshtatshme për nxënësit nga klasa e 5 deri në të 8 të shkollës 8 vjecare.

Materiale : Artikuj nga gazetatat dhe revistat. Pjesë të zgjedhura dhe marrëdhënet e dhunës marrë nga interneti (Nqs ka mundësi).

Metoda : Lexim dhe diskutim të gazetave. Diskutim mbi problemet dhe ngjarjet e fundit.

Koncepti : Jo dhunës, drejtësi, hero/heroinë, përgjegjësi sociale.

Objektivat : Studentët duhet të jenë të aftë që ;

- Të vlerësojnë forma dhe nivele të ndryshme të dhunës.
- Të analizojnë karakteristika të ndryshme të viktimave dhe të kuptojnë se si fillon një dhunë e drejtpërdrejt.
- Të fillojnë të hedhin ide për ndryshim.

Mënyra :

1. Filloni të mblidhni materialet një javë para se sa ta diskutoni në klasë. Çdo student duhet të mbledh të paktën një dyzinë me pjesë nga gazetatat. Pjesë të marra nga konfliktet, dhuna, dhe mosmarrveshjet.
2. Mësimi fillon duke vendosur dhe kategorizuar gjithë koleksionin me pjesët e mbledhurar në një hapsirë të madhe dhe të përshtatshme.
3. Krijoni kategori sipas këtyre klasifikimeve të mëposhtme;
 - Dhuna në qytetin tonë
 - Dhuna ndaj fëmijëve
 - Dhuna ndaj grave
 - Dhuna kundër një shteti tjetër
 - Dhuna në rrugë
 - Dhuna ndërmjet dy grupeve
 - Dhuna ndërmjet armiqëve
 - Dhuna në vendin e punës
 - Dhuna që ushtron qeveria dhe policia

Kur të gjitha të jenë shperndarë dhe klasifikuar le të nisë diskutimi mbi kategoritë e gjetura. Pyesni nxënësit nëse ne, ata jetojnë në paqe. Cilët janë ata që janë gjithmon nën presionin e dhunës? Inkurajoni nxënësit të shikojnë panoramën e madhe të paqes dhe dhunën brenda saj. I inkurajoni të flasin për paqen e vërtetë. Dhe i lini të reflektojnë se si ne mund ti zgjidhin konfliktet në paqe.

4. I lini nxënësit të reflektojnë se çfare ndryshimesh duhen bërë që ne të jetojmë në një kulturë paqeje; Në qytetin tonë, në klasën tonë, në familjen tonë, në vendin tonë dhe në botë.

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 4

Të ndryshmit dhe Diskriminimi

Shkolla 8 vjecare, Cikli i lartë

Intoleranca etnike, fetare, dhe raciale dhe nacionalizmat janë burimet kryesore të konfliktit modern.

*Thirrja e Hagës për paqe promovon metoda për të eliminuar dhe zvogëluar manipulimet
politike në lidhje me ndryshimet
raciale, etnike, fetare dhe gjinore kundrejt
qëllimeve politike dhe ekonomike
Akhenda e Hagës, Rekomandime 5, fq 17.*

Ushtrimi i mëposhtëm është bërë për të ndihmuar nxënësit për të kuptuar më mirë lidhjen që ekziston ndërmjet ndryshimeve dhe Diskriminimit. Dhe gjithashtu që ti ndihmoj për të kuptuar që nuk duhet të fillojmë të diskriminojmë një njeri vetëm në bazë të ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet individve të ndryshëm.

Marrë nga: Manuali për burimet dhe mësimdhënien e zgjidhjes së konflikteve, edukimi për të drejtat e njeriut, Paqja dhe demokracia. Shkruar nga Sanna Osseiran. Ky libër është publikuar nga Qendra kërkimore dhe e zhvillimit didaktik, Beirut, Liban në bashkëpunim me shoqatën internacionale për kërkime mbi paqen (IPRA) and UNESCO, 1994, fq 48.

Mosha dhe Subjekti: Shkolla 8-vjecare, cikli i lartë.

Materiale: Shkumsa dhe dërrasë e zezë

Metoda: Hedhja e ideve, diskutimi në grupe dhe nxjerja e ideve të përbashkta.

Koncepti: Drejtësi, Etnicitet, Diskriminim, Të drejtat e njeriut, Toleranca.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që ;

- Të zhvillojnë konceptin e të ndryshmit nga ata, kuptimin e diskriminimit dhe ndryshimet midis tyre.
- Tu paraqiten shembuj real nga jeta e përditshme dhe më tej të diskutojnë mbi këto ngjarje.

Mënyra:

Fillimi i diskutimit.

Faza 1; Mësuesi duhet të shkruaj në dërrasën e zezë fjalën “Diversitet” dhe pastaj të pyes pjesmarrësit të japin idetë e tyre në lidhje këtë. Te shpjegoj që kjo është faza ku çdo student duhet të thotë lirshëm fjalën e tij dhe se askush nuk do ta vlerësoj apo paragjykoj për atë që po thotë.

Faza 2; Mësuesi shkruan në dërrasën e zezë të gjitha komentet pa bërë vetë asnjë koment.

Faza 3; Pasi I ka shkruar të gjitha në dërrasën e zezë mësuesi fillon i analizon me rradhë në lidhje me afërsinë që kanë ato me konceptin e “diversitetit”.

DISKUTIMI RRETH ÇËSHTJES

Faza 4; Mësuesit duhet ta udhëheqin diskutimin rreth koncepteve të “ndryshimeve” dhe “diskriminimin”. Të përpiqet të saktësojë dhe të jap konceptin e saktë për kuptimin e fjalës “ndryshim” dhe ta vërë atë të përballet me konceptin “diskriminim”. Jepini të kuptojnë sesi ndryshimi ka të bëjë me jo-barazinë ose jo-një trajtësinë midis dy njerëzve ose midis dy sendeve. Diskriminimi lidhet ngushtë me ndryshimin si një mosbarazi sociale dhe gjykim mbi vlerat sociale.

PËRFUNDIMI

Faza 5; Punoni me klasën për të kuptuar që ndryshimi të shihet si një pasuri më e madhe që ne kemi në dispozicion. U shpjegoni që tek njerëz të gabuar ky ndryshim mund të kthehet në padrejtësi dhe dhunë. Meqë ndryshimi në vetvete përmban diferenca natyrale (siç janë ekosistemet, balancat ekologjike etj) diskriminimi është i manipuluar nga njerëzit dhe shpikur që disa njerëz të fitojnë sa më shumë duke dëmtuar njerëz të tjerë.

Faza 6; Nëqoftëse dëshironi mund ti thoni klasës të mendoj se si mund të ishte ky ndryshim që në vetvete të mos përmbante diskriminimin në jetën e përditshme. Çfarë mund të bëhet për të filluar të ndërtojmë këtë vizion?

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 5

Lufta në Ceceni

Shkolla 8-vjecare, cikli i lartë.

Metodat tradicionale për ti parandaluar luftës dhe për të ndërtuar paqen në një farë mënyre kanë dështuar.

Kjo duket qartë me brutalitetin e luftës që është gjithmonë në ngritje dhe mos-interesin për jetët civile. Përdorimi i forcës nuk është kurrë demokraci.

Lufta ne Ceceni! Një trajtim dhe studim fillestar.

Ky leksion është I përshtatshëm për studimin e temave mbi luftën dhe mund të përdoret në lëndën e historisë, studimeve sociale ose studime konfliktesh. Ky lloj studimi mund të përshtatet për amerikanët në lidhje me luftën e Vietnamit, luftën e Filipineve 1898, luftën civile, luftën në Meksikë në 1840. Në Angli mund të përdoret për masakrat në Irlandë. Për Francën problemet që ka pasur në Algjeri dhe Indokinë dhe në luftrat e Napoleonit. Japonia në mesin e shekullit të 20 për luftrat që ka bërë në Azi dhe në Paqesor. Procesi mësimor të ndimon të kuptosh qëllimet e vërteta të luftës, natyrën e saj si edhe alternativat që ekzistojnë për ta shmangur atë. Në të gjitha rastet studentët janë të lutur të japin alternativat e tyre për të shmangur luftën dhe për të mbrojtur paqen.

Marrë nga: Ky leksion është punuar nga Emilia Solokove dhe Marina Zionieva që punojnë pranë qendrës për kulturën mbi paqen në Moskë. Universiteti i Prospektit

Mosha dhe Subjekti: Për tu përshtatur për nxënësit e shkollës 8 vjecare, cikli i lartë. Histori dhe studimet sociale.

Materiale: Një shikim të shpejtë mbi luftën në Ceceni. Materiale të mbledhura mbi të dhe gjithashtu një konsult në dokumentet që gjenden mbi këtë çështje në Thirrjen e Hages për Paqe. Dërrasën e zezë dhe shkumësa.

Metoda: Në fillim krijoni një pyetsor. Pastaj dëgjoni mendimin e një eksperti. Më tej vazhdoni me studimin e materialeve të mbledhura. Formimi i një opinionit. Një debat parlamentar dhe më në fund votimi.

Koncepti: Konflikt i armatosur, kolonializmi, nderhyrja, nacionalizmi, jo-dhuna, pavarësia, demokracia.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që:

- Të studiojnë një luftë ose konflikt të tanishëm duke u bazuar në kontekstin historik.
- Të analizojnë mbi këto dije dhe të propozojnë mënyrë për të dalë nga këto kriza.
- Të zhvillojnë në mes të studentve kulturën e paqes dhe të jo-dhunës dhe studiojnë kulturën e paqes.
- Të trajtojnë të rinjtë të zgjidhin konfliktet duke përdorur qëllime humane dhe paqedashëse.

Mënyra:

Fillimi i diskutimit.

Subjekti i këtij leksioni është marrë një kurs me temën “Rusia nën Nikollën e parë ”

1; Përgatitja për leksionin fillon me gjetjen e këtyre materialeve mbi historinë dhe marrdhëniet midis Rusisë dhe popujve nga Kaukazi. Gjithashtu duhet të bashkangjitet edhe materiali mbi luftën e tanishme në Ceceni. Gjatë studimit studentve duhet tu jepet një listë e gjatë me rekomandime dhe rezultate studimesh mbi këtë konflikt.

2; Ky leksion duhet të ndërtohet si një mbledhje e Dumës (parlamentit rus) në një sesion parlamentar me pjesmarrjen e grupeve të ndryshme në të. Numri i grupeve duhet të zgjidhet në bazë të anketimit paraprak në të cilin do të dalin dhe numri I mendimeve të ndryshme që ekzistojnë në sallë.

3; Filloni dhe zhvilloni aktivitetet e mëposhtme ;

3a- Shkruani në dërrasën e zezë konceptet kryesore të diskutimit dhe pastaj pyesni se si çdonjeri prej tyre mund të shihet ndërmjet konteksteve të ndryshme të luftrave të ndyshme përfshi këtu prapaskenat, luftën dhe përfundimin e luftës.

3b- Pyesni studentët të reflektojnë disa minuta sesi të shikojnë dhe kuptojnë deklaratën e Thirjes së Hagës “Dështime tradicionale” e cila ishte dhe manifesti i kësaj lufte.

3c- Formoni grupe të vogla studentësh që të fillojnë të gjejnë dhe te japin idet e tyre për zgjidhjet e këtij konflikti dhe ti thonë ato para klasës.

3d- Çfarë mundësish eksiztojnë që këto ide të bëhen realitet? Si mund të na ndihmoj Thirrja i Thirrjes së Hagës për të sjellë këto ndryshime?

3e- Si mundet që realizimi dhe vënia në funksion e të drejtave të njeriut dhe praktimi i demokracisë të ndihmoj që në të ardhmen te parandaloj dhe ndaloj luftrat.

Kapitulli i Parë:

Rënjët e luftës / Kultura e paqes

Leksioni 6

Vizioni i Corës

Shkolla 8vjecare. Cikli i lartë

Ne e kemi përqaftuar tashmë moralin

dhe kurajon e nevojshme për të krijuar në shekullin e 21 një kulturë paqeje

*dhe të zhvillojmë insitucione dhe organizata internacionale që garantojnë
paqen dhe drejtësinë në botë.*

Axhenda e Hagës, Parathënia, fq 3.

Një nga menyrat më të mira pedagogjike për të zhvilluar kulturën e paqes është që të fillojmë të imagjinojmë të ardhmen dhe transformimet në botë duke përqafuar dhe duke ditur gjendjen aktuale të paqes dhe drejtësisë në botë dhe duke u mbështetur në 50 rekomandimet e Thirrjes të cilat janë hapat e parë drejt kësaj rruge.

Mësuesit e paqes prej kohësh e kanë kuptuar që është e nevojshme të kultivosh “imagjinatën me baza të forta morali” të nxënësve kështu që do mund ti ndimosh ata ta shohin paqen si më të preferuarën për të tashmen dhe më idealen për të ardhmen. Këto leksione të ndimojnë për të filluar të imagjinosh të ardhmen në bazë të ndryshimeve të cilat ne vetë i zgjedhim dhe i implementojmë.

Marrë nga: “Vizioni për gratë e Shekullin të 21”; ishte fjala e mbylljes në sesionin e fundit të Gjykatës së grave mbledhur nga Cora Weiss drejtore e organizatës “Thirja e Hagës për paqe” 7 Mars 2001 në Kejptaun në Afrikën e Jugut,

Mosha dhe Subjekti: Shkolla e mesme

Materiale: Kopje të “Vizioni për Gratë në Shekullin e 21”, kopje të Thirrjes së Hagës dhe dërrasë e zezë

Metoda: Diskutimi, analizimi i teksteve, një vizion për kulturën e paqes, planifikime të strategjive tranzicionale për ndryshim, hedhja e ideve për mundësitë reale për ndryshim, identifikimi i metodave të reja që do të mund të ndihmojnë për të cuar përpara procesin e ndryshimeve.

Koncepti: Kultura e paqes, barazi gjinore, aksione për ndryshime sociale.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që ;

- Përshkruajnë gjendjen botërore në të cilën ju besoni se karakterizojnë një kulturë paqeje.
- Identifikojnë ndryshimet më të madhaja që duhen ndërmarrë për të arritur të tilla rezultate.
- Identifikojnë se çfarë duhet të bëjnë individë të caktuar, shoqata civile apo oraganizata shtetërore për të arritur këto ndryshime.
- Thonë se me çfarë duhet të jenë të përgatitur individët për të arritur te ky proces ndryshimesh.
- Konsiderojnë marrëdhënien që ekziston midis sekseve dhe paqes.

Procedura :

Faza 1; Shpërndani tekstin “Vizioni për gratë në shekullin e 21”. Pyesni studentët ta lexojnë dhe të fillojnë ti japin përgjigje pyetjeve që gjenden në tekstin aty.

Faza 2; Pastaj formoni grupe të vogla për të diskutuar mbi rrjedhojat e mundëshme që do të kishin këto pyetje. I caktoni një pyetje çdo grupi.

Faza 3; Mbasi të merrni përgjigjet nga grupet saktësoni rrjedhojat për ndryshimet që janë të mundshme për tu bërë.

Faza 4; Pyesni studentët të rikthehen përsëri në punën në grup dhe të thonë që së bashku ndryshimet që duhen bërë për problemet që atyre ju duken më akute.

Faza 5; Pyesni studentët për ëndrrat e tyre për paqe dhe se si mund ti realizojnë ato.

Faza 6; Mbas diskutimit dhe parashtrimit të ëndrrave të secilit i pyesni se për çfarë kanë nevojë të dinë dhe të mësojnë për të punuar për paqen.

Faza 7; Bëni një listë me objektivat që duhet të kenë dhe studiojnë që ato të fillojnë të punojnë për paqen.

VIZIONI PËR GRATE NË SHEKULLIN E 21

Çfarë është AIDS vetem me një folje???

Si do të ishte nëqoftëse njerzit do të luftonin kundër kompanive të medhaja farmaceutike dhe njerzit e paqes të ndimonin njëri tjetrin??? Do të mundim të shtonim numrin tonë dhe të forcës tonë?

Si do të ishte nëqoftëse 1 bilion armë të vogla qe kanë dale jashtë kontrollit që vrasin çdo vit 6 milion njerëz ne botë, të shkatërroheshin të gjitha?

Si do të ishte nëqoftëse tregtisë së armve do ti viheshin taksa ose do të ndalohej?

Po nëqoftëse fëmijve në shkollë do tu mësonim lëndë të reja; si bashkëpunimi dhe afrimi me njëri tjetrin?

Si do të ishte nëqoftëse paqja do të jepej si lëndë në shkolla?

Si do të ishte nëse mund të zgjidhej në mënyrë jo të dhunshme konflikti?

Si do të ishte nëqoftëse armët bërthamore do të zhdukeshin?

Si do të ishte nëqoftëse të gjitha kandidatët për çdo nivel pushteti të ishin gra?

Si do të ishte nëqoftëse gratë do të merrnin pjesë në çdo tavolinë negociimi?

Unë ëndërroj që të drejtat e njeriut kurrë nuk duhen të ndahen nga paqja dhe drejtësia!

Unë ëndërroj që të gjithë fëmijët të lexojnë deklaratën universale mbi të drejtat e njeriut dhe konventën mbi të drejtat e femijve!

Unë ëndërroj që asnjë shtet mos të ketë buxhetin për ushtrinë më të madh se sa është buxheti i edukimit dhe shëndetësisë së bashku!

Unë ëndërroj që gratë të mos jenë më statistikë, jo më!

Unë ëndërroj që gratë dhe burrat do ta ndajnë pushtetin bashkë një ditë dhe do rendin mbas pushtetit të bashkuar!

Kapitulli i Dytë:
Ndihma Humanitare,
Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 7

Konventa është e rëndësishëme

në jetët e fëmijëve

Cikli i ulët

*Thirrja e Hagës për paqe mbështet iniciativa për të siguruar
adoptimin universal dhe implementimin e Konventës
të të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë këtu dhe
zhdukjen e punës për fëmijët dhe marrjen e tyre si ushtarë.*

Akhenda e Hagës, rekomandime 7, fq 19.

Leksioni në vazhdim prezanton “Konventën mbi të drejtat e fëmijëve”. Pema e jetës është një metaforë e bukur për tu përdorur në edukimin e të drejtave të njeriut. Metaforat mbi sistemin e jetës mund të ndihmojnë gjithashtu për të prezantuar nxënësit me problemet ekologjike. Ky leksion (bashkë me leksionin 8) është shkruajtur nga Susan Lechter, një kanadeze që ka mbaruar universitetin e Havardit dhe kolegjin e mësuesve në Columbia.

Marrë nga: Ky leksion është punuar/përshtatur nga Betty A.Reardon, “Edukimi për dinjitetin Human” dhe “Të mësosh rreth të drejtave dhe detyrimeve”, Filadelfia: Gazeta e universitetit të Pensilvanisë, 1995, fq 51-56.

Mosha dhe Subjekti: cikli i ulët

Materiale: Letra për të shkruajtur, lapsa me ngjyra, dërrasë për ti vendosur këto dhe një kopje të “Konventës mbi të Drejtat e Njeriut”

Metoda: Të saktësojmë mirë dhe të dimë të dallojmë midis të drejtave dhe nevojave, të interpretojmë së bashku artikujt e konventës.

Koncepti; Konventa ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, nevoja themelore.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Nxënësit duhet të jenë të aftë për të mbledhur informacion mbi të drejtat e fëmijve duke studiuar disa nga artikujt e konventës dhe gjithashtu ata duhet të drejtohen për të kuptuar vështirësit e përmbushjes së konventës.
- Për të zbuluar së bashku disa problemet e rëndësishme që kanë fëmijët dhe për të punuar së bashku që ti zhdukim ato.
- Të zhvillojmë sensin e ndarjes individuale të rajoneve të botës dhe të zhvillojmë respekt për të tjerët rreth nesh dhe për fëmijët që janë viktime fatkeqësish.

Ky leksion duhet të bëj të mundur që;

- Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë midis dëshirave dhe nevojave;
- Të identifikojnë nevojat themelore për të mbijetuar;
- Ata duhet të mësohen me konventën dhe ta kenë atë shumë familjare.

Procedura:

1. Vizatoni pemën e jetës mbi një pjesë të madhe të dërrasës së zezë. Rrënjët mund të prezantojnë të drejtat themelore të fëmijve. I thoni fëmijve që kjo pemë nuk do të mund të mbijetojë pa ushqimin dhe trajtimin e duhur dhe gjithashtu dhe pa ndihmën e fëmijve. I pyesni se për çfarë ka nevojë pema të rritet? I pyesni pse pemët janë të rëndësishme në jetën tonë.
Pyesni se për çfarë kanë nevojë fëmijët për tu rritur?
Trungu përfaqëson të gjithë konventën. Degët përfaqësojnë principet themelore të konventës. I pyesni kur fëmijët gëzojnë shëndet të mirë dhe mirëqenie a është i gjithë komuniteti më mirë apo jemi ne që vetëm atyre fëmijve ua kemi siguruar këtë?
Degëzat e reja mund të përfaqësojnë artikujt e vecantë të konventës dhe çdo syth prezanton çdo fëmijë të klasës. Kjo pemë jete mund të jetë një simbol i vërtetë i jetës reale.
2. Në copa të vecanta letre shkruani përmbledhjen e artikujve që secili diskutoi në klasë.

I ndani nxënësit në grupe diskutimi. Çdo grupi ti jepet nga një përmbledhje. Pasi ti keni shperndarë ato I lexoni me zë të lartë ti degjojë e gjithë klasa. I jepni mundësinë disa minuta nxënësve ti dikutojnë ato. U jepni fleta bosh dhe u thoni të shkruajnë të drejtat e tyre dhe nevojat e tyre.

3. Në grupe të vogla nxënësit do bëjnë vizatime që të prezantojnë një artikull të konventës, do ti vendosin numrin e artikullit çdo vizatimi dhe do i vendosin vizatimet në muret rreth klasës. Pastaj mësuesi do ti vendosi numrat tek çdo syth i pemës së jetës.
4. U thoni që duhet të vizatojnë të gjithë artikujt derisa ato të mbarojnë të gjitha...E përsërisni derisa të gjitha artikujt të jëtë diskutuat dhe vendosur mbi pemë.

Kapitulli i Dytë:

Ndihma Humanitare,

Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 8

FEMIJËT KANË NEVOJË PER TU MBROJTUR
NGA DËMTIMET DHE OFENDIMET

Cikli i ulët

*Femijët dhe të rinjtë vazhdojnë të përdoren duke u viktimizuar, vecanërisht në konflikte
ku të dëmtosh dhe keqpërdorësh këto fëmijë është bërë një strategji lufte.*

Akhenda e Hagës, rekomandime 7, fq 19.

Grupi i aktiviteteve të mëposhtme ka si qëllim të tregojë se standartet e të drejtave të njeriut kanë si prioritet të sigurojnë që asnjë të mos vuaj padrejtësisht dhe të ndihmoj fëmijët të rriten të sigurtë dhe me arsimin e duhur për të gjetur rrugën e duhur në të ardhmen e tyre.

Marrë nga: Ky leksion është punuar/përshtatur nga Betty A. Reardon, “Edukimi për dinjitetin Human” dhe “Të mësosh rreth të drejtave dhe detyrimeve”, Filadelfia: Gazeta e universitetit të Pensilvanisë, 1995, fq 51-56.

Mosha dhe Subjekti: Cikli i ulët

Materiale: Kopje të “Konventës për të drejtat e fëmijve”, materiale për të vizatuar, materiale për të ndërtuar kukulla prej letre.

Metoda; Përdorni një problem duke e bazuar në një histori të vërtetë dhe duke përdoruar kukullat e vini në skenë nëpërmjet një teatri të vogël.

Koncepti: Sigurim, ofendime, ndryshime kulturore, përgjegjësi ndaj fëmijve etj.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Nxënësit duhet të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së fëmijve nga çdo problem dhe sigurimin për mbarë-rritjen e tyre (artikulli 20, 33, 36);
- Të kuptojmë që të gjithë fëmijët pa përjashtime race, gjinie, kombësie, feje ose problemi shëndetësor janë përfshirë në konventë (artikulli 2, 22, 23, 30)
- Duhet të dinë që asnjë fëmijë nuk duhet të bëhet viktimë e keqtrajtimit ose abuzimeve të çdo lloji (artikulli 36, 37)
- Të kuptojnë që fëmijët kanë nevojë për një përkujdesje të vecantë për tu rritur siç duhet. (artikulli 2, 22, 23, 30)

Mënyra:

1. Mund të përdorni një skenar ku një fëmijë i është ndaluar të marrë pjesë në një klasë ose e ka të pamundur të shkojë atje. Fëmijët mund ta luajnë direkt këtë pjesë ose mund të bëjnë kukulla për ta vënë në skenë këtë pjesë. Diskutimi duhet të rrotullohet rreth temave se si duhet të shmangen këto jo-pjesëmarrje dhe se si fëmijët janë të pafuqishëm për ta ndryshuar vetë këtë realitet. Si mund të planifikojmë aktivitetin për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithëve.

Ç’do ndodh nëse një fëmijë është pak më ndryshe nga të tjerët ? Çfarë përgjegjësie mban klasa në lidhje me kufizimet që u bëhen nxënësve të ndryshëm.

2. Diskutoni mbi ndjenjat dhe emocionet e nxënësve në lidhje me fëmijët refugjatë që s’kanë shtëpi dhe kanë pak të drejta. Diskutoni në këtë rast ç’do të thotë fjala siguri? A ndihen nxënësit tuaj të sigurt? Pse ose pse jo? Në çfarë mënyre ato i shohin problemet e tyre?

3. Sistemi i shokut mund të përdoret për të vënë në bashkëpunim klasat më të mëdhaja me nxënës më të vegjël, që të shkëmbejnë së bashku eksperiencat e tyre dhe më të mëdhënjt ti ndimojnë me ato pak që dinë më shumë. Këto grupe mund tu themi që duhet të punojnë së bashku dhe të paktën një herë në javë të takohen, dhe gjithashtu mund të takohen dhe me grupet e tjera për të gjetur dhe propozuar kërkesat e tyre, gjithmonë brenda sistemit shkollor.

Pastaj fëmijët duhet të ndahen në dy grupe të mëdhaja; të mëdhenjtë në një dhe me të rinjtë në një tjetër. Të mëdhenjtë duhet të flasim për eksperiencën e tyre dhe efikasitetin e këtij trajnimit dhe të vegjlit për emocionet që ndien dhe nëse ishte e dobishme për ata të ndimoheshin nga më të mëdhenjtë.

4. Rivizatoni pemën e jetës. Shihni artikujt që gjenden në lidhje me aktivitete të tilla, i zbukuroni dhe i rivendosni në pemë.

5. Zgjidhni disa kultura të ndryshme dhe i prezantoni ato në klasë. Shpjegoni se si pema e jetës mund të jetë e ndryshme për fëmijë të ndryshëm në botë. Kërkesat mund të jenë shumë shumë të ndryshme dhe atëherë diskutoni mbi universalitetin e nevoja themelore të fëmijve, në mënyrë të vecantë për të ruajtur dhe kujdesuar nga rreziqet.

6. Mbyllja; U thoni fëmijve të vizatojnë pemë jete individuale duke shprehur secili shqetësimet e tija dhe aspiratat e tija në lidhje me të ardhmen. Vendorsja do të jetë e njëjtë si tek pema e jetës duke filluar nga rrënjët, trunghi, dega etj etj. Të gjitha vizatimet bashkë i vendosni në një faqe muri në klase dhe aty do keni formuar pyllin e jetës. Tani që gjithcka është kompletuar i pyesni fëmijët të flasin për dëshirat e tyre, të ardhmen, kërkesat e nevojat e tyre.

Kapitulli i Dytë:

Ndihma Humanitare,

Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 9

Nevojat, të Drejtat dhe Dinjiteti Human.

Dhunimi i të drejtave humane është një nga shkaqet esenciale që cojnë drejt luftës. Këto dhunime përfshijnë: refuzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, sikurse të drejtat politike dhe të drejtat civile

Deklarata universale e të drejtave të njeriut është gati një nga materialet me themelore për tu përdorur në edukimin e kulturës për paqe.

Marrë nga: Ky leksion është punuar nga Richard P. Claude, “Kambanat e Paqes” Etiopi. Ky rast është bazuar nga një libër që përdoret për trajnimin e të drejtave të njeriut në Etiopi.

Mosha dhe Subjekti: cikli i mesëm

Materiale: Një kopje e “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, dërrasë e zezë, shkumsa, ngjyruesa.

Metoda: Të indetifikojmë nevojat humane dhe të drejtat relative. Të vlerësojmë nivelin e aplikimit të këtyre të drejtave tek nxënësit dhe të analizojmë dokumentet e të drejtave të njeriut.

Koncepti: Drejtësi, Të drejtat humane dhe nevojat.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të bëhen familjarë me deklaratën universale e të drejtave të njeriut
- Të kuptojnë më mirë mardhënien dhe bashkepunimin midis të drejtave dhe përgjegjesive.
- Të zbulojnë dhe indetifikojnë ndryshimin midis nevoja humane dhe të drejtave humane
- Të zbulojnë kushtet për një shoqëri të paqme dhe të drejtë.

Procedura;

Prezantoni një kopje të të Deklaratës Universale të të Drejtës Humane.

1. Pyesni nxënësit të bëjnë një list me të gjitha nevojat themelore që gjenden tek një njeri. I shkruani këto nevoja në dërrasën e zezë.
2. U sugjeroni nxënësve ti ndajnë këto nevoja sipas kategorive të ndryshme si psh; Për mbijetesë, për mirëqënien psikologjike, atë sociale. Ose psh pjesëmarrjen në vendim marrje. I ndani keto nevoja sipas kësaj kategorie dhe vazhdoni ti mbani në dërrasën e zezë.
3. I ndani nxënësit në grupe dhe për çdo grup u thoni të studiojnë një nga kategoritë e të drejtave që ato i hasin dhe në jetën e përditshme. E ndërtoni shoqërinë të tillë që njerzitet të dinë kush janë nevojat e tyre dhe aftësit e tyre dhe u siguroni mënyrën për të përmirësuar kualitetin si qenie humane
4. Pyesni nxënësit të shkruajnë se si mendojnë ata se do të jetë shoqëria e cila do ti lejoj ata të kenë të plotësuar të gjitha kërkesat dhe nevojat e tyre dhe ti ndihmoj ne zhvillim e tyre potencial si qenie humane.
5. U thoni grupeve që secili nga ato të thonë mendimin e tyre me disa fjalë. Pastaj mësuesja duhet ta ndaj dërrasën në tre grupe 1) Nevojat Humane 2) Kushtet aktuale të shoqërisë 3) Kushtet dhe kërkesat për të ardhmen.
6. Duke ndërtuar dhe një kollon të katërt mësuesja duhet të shpjegoj ndryshimet që të drejtat humane kanë nevojë për të mbrojtur, ndryshuar dhe zhvilluar jetën e dikujt. Shjeroni që për

çdo nevojë themelore ka një të drejtë humane. Shkruani pranë çdo nevoje themelore të drejtën e garantuar nga Deklarata Universale.

7. Hapni një diskutim mbi grupin e dytë, ku mund të gjejmë të dhunuara të drejtat humane dhe grupin e tretë për të kuptuar ndonjë herë se si gënjehet kur thuhet që të drejtat e njeriut më në fund po respektohen, janë të mbrojtura dhe të promovuara tashme në çdo vend. I pyesni se çfarë mund të bëjmë sot në shoqërinë tonë që nevojat humane ti afrojmë sa më shume me të drejtat humane? Çfarë mund të bëhet nga organizata internacionale si psh, Kombet e Bashkuara ose nga organizata që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat humane?

Kapitulli i Dytë:

Ndihma Humanitare,

Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 10

Çmobilizimi i Fëmijve ushtarë, Thirja e Hagës për paqe inkurajon OJQ jo qeveritare për të kontribuar në fushatën kundër mobilizimit të fëmijve si ushtarë dhe për të eksploruar metoda të tjera që të drejtat e fëmijve të respektohen.

Në luftrat e fundit dhe në mënyrë të vecantë në Afrikë, shumë fëmijë janë marrë si ushtarë dhe kanë marrë pjesë në konflikte të armatosura. Kjo situatë është në mënyrë të vecantë thyerje e të Drejtës Internacionale për të Drejtat e Njeriut dhe sidomos thyerje mbi të Drejtat e Fëmijve.

Marrë nga: Kjo pjesë është bazuar mbi të dhënat nga një Ojq që punon si pjesë e Kombeve të Bashkuara. Kjo pjesë tregon për nevojën e çmobilizimit të fëmijve ushtarë.

Mosha dhe Subjekti: cikli i mesëm

Materiale: Deklarata e Shoqatës Pax Christi pranë Komisionit të Kombeve Të Bashkuara. Rekomandimi 19 i thirjes së Hagës për Paqe dhe konventa për të drejtat e fëmijve.

Metoda: Punë kërkimore mbi problemin në fjalë, hartimi i një strategjie për pjesmarrjen civile aktive në zgjidhjen e këtij problemi.

Koncepti: Komunizmi, militarizmi, konflikt i armatosur, të drejtat e njeriut.

Objektivat: Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të fitojnë aftësi për të njojtur dhe kuptuar shumëllojshmërinë dhe format e një konflikti të armatosur.
- Ti prezantohet mënyra e jetesës e një fëmije ushtarë dhe gjithashtu kushtet e tij
- Të njihen me konventën mbi mbrojtjen e fëmijve.
- Të njihen me konceptet për të Drejtat e Njeriut.
- Të prezantohet me mënyrën e funksionimit e Kombeve të Bashkuara.
- Të kuptojnë rëndësinë e e ligjit internacional për parandalimin dhe dënimin për çdo thyerje të të Drejtave të Njeriut.

Mënyra;

1. Shpërndani kopje nga statuti i Pax Christit dhe nga Konventa e të drejtave të Fëmijve gjithë klasës ta lexojnë si detyrë shtëpie.

2. Shpjegoni se çfarë janë organizata botërore e punës dhe Komisioni për zhvillimet sociale pranë Kombeve të Bashkuara. Shpjegoni si funksionojnë ato dhe ç’lidhje kanë me të drejtat e njeriut.

3. I ndani me pas në grupe për të ndërmarrë këto detyra;

Kërkoni nëpër gazeta, revista etj rreth problemit të fëmijve ushtarë. I sillni këto copa në klasë dhe I vendosni në mënyrë që të gjithë të kenë mundësinë ti lexojnë.

Kërkoni pranë Komisionit për Zhvillimet Sociale dhe UNICEF për të mësuar përgjegjësitë e tyre në lidhje me të drejtat e fëmijve.

Kërkoni mbi historinë se si ishin fillimet e Konventës së të Drejtave të fëmijve.

4. Lexoni Ditarin e Hagës, rekomandimin 19, në klasë dhe u thoni fëmijve që kjo temë do të diskutohet nesër.

5. U thoni fëmijve të reflektojnë mbi gjendjen e fëmijve ushtarë dhe u thoni atyre ta shohin në prizmin e mirëqenies së sotme sociale.

6. Orën tjetër të mësimit e hapni me pyetjen “kush janë viktimat e luftës”.

7. Vazhdoni të mblidhni idetë se ç' duhet të bëhet për të eliminuar problemit e fëmijve ushtarë. Fëmijët duhet të zgjedhin 3 aktivitete për të bërë dhe të ndahen në grupe. Mësuesja duhet ti asistojë sa më pak të jetë e mundur dhe ti lerë fëmijët të lirë të shprehin vullnetin dhe dëshirat e tyre.

8. Mbani një ditar për atë që fëmijët po bëjnë dhe mbi suksesin e punës së tyre.

Kapitulli i Dytë:
Ndihma Humanitare,
Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 11

Gjykata Internacionale e krimeve kundër luftës përbën hapin e parë që prej luftës së Dytë

Botërore për kapjen dhe dënimin e kriminelve që kanë shkelur

ligjin mbi të Drejtave e Njeriut

Akhenda e Hagës, rekomandimi 14, fq 24

Akhenda e Hagës, rekomandimi 15, fq 25

Krimet e fundit që dhe lidhen drejtpërdrejt me dhunime të të drejtës ndërkombëtare janë shfaqur si në Europë dhe në Afrikë. Gjykata kundër krimeve të luftës është në një proces rritjeje dhe zmadhimi në shekullin e 21. Shoqëria civile po luan një rol shumë të madh në zhvillimin e Statutit të Romës për ti dhënë sa më shumë rëndësi kësaj Gjykate që në të ardhmen të luaj një rol sa më të madh, në kërkimin e të drejtës për viktimat e pambrojtura të luftimeve dhe të çdo thyerje të ligjeve ndërkombëtare.

Marrë nga; Ky simulim është shkruajtur nga autorët e librit “Të mësojmë për të eliminuar luftën”, si një ndihmës për tu njojtur me “Ligjin e Ndihmës dhe të Drejtave Ndërkombëtare”.

Mosha dhe Subjekti: cikli i mesëm

Materiale: Kopje ose përmbledhje të dokumenteve që kanë të bëjnë me të Drejtat e Njeriut. Vendimin e Gjykatës për rastin e krimeve të kryera në Bosnje, të cilat u quajtën krime kundër njerzimit. Vendimin e Gjykatës Internacionale të Grave për Krimet në luftë, Tokio, Dhjetor, 2000.

Metoda; Punë kërkimore mbi problemin, analiza dhe diskutime, simulime dhe lojra me role te ndryshme në konfliktet në fjalë.

Koncepti; Ligji Internacional, Të Drejtat e Njeriut, Krime kundër Njerzimit, Krime gjinore, Gjykata Internacionale.

Objektivat; Studentët duhet të jenë të aftë që;

- **Të rishikojnë dhe të vlerësojnë standartet e ligjit Internacional për të Drejtat e Njeriut.**
- **Të njihen me procedurat dhe mënyrën e funksionimit të Gjykatës Internacionale.**
- **Të kuptojnë rëndësinë e ligjit internacional për të dënuar dhe shmangur krimet kundër njerzimit.**
- **Të kuptojnë fuqinë që disponon ky ligj internacional si një mënyrë për të shmangur luftrat dhe të eliminojmë konfliktet e armatosura.**

Filloni të flisni për Paqen si koncepti bazë mbi të cilin janë ngritur dhe këto masa parandaluese.

U tregoni paksa historinë e kësaj gjykate në lidhje me vendimet e marra kundër Qeverisë Japoneze në lidhje me shkeljen e të drejtave të grave. Vlerësoni se sa krime të tjera nuk janë sjellë para drejtësisë. Kujdes; I lajmëroni nxënësit që ky leksion për nga përmbajtja që ka ndikon emocionalisht shume tek ata dhe në qoftëse nuk ja dalin dot mund të largohen.

Gjykata Internacionale e Grave mbi Krimet e Luftës.

Në Dhjetorë, 2000 Gjykata kundër krimeve të luftës u mbajt në Tokio, Japoni. Kjo ngjarje u organizua nga shoqatat jo qeveritare të grave nga Japonia, Korea e Jugut, dhe Filipinet. Kjo Gjykatë u mblodh për të mos lënë pa dënuar krimet që ushtria Japone ka kryer kundër grave ne luftën e dytë botërore.

Këto organizata mbas vitesh kërkimesh kishin arritur të mblidhnin shumë materiale për te evidentuar skllavërimin, për të ofruar më mbrapa shërbime seksuale për ushtrinë Japoneze në zonat e luftimit të shumë grave dhe vajzave të reja, disa prej të cilave ishin shumë të vogla në moshë, të marra nga Korea, Kina, Indonezia, Malajzia dhe Filipinet.

Rezultatet e këtij Gjykimi janë shumë të rëndësishme për të krijuar bazën e një ligji të ri Internacional i cili do të bazohet në kapjen dhe dënimin e të gjithave krimeve të kryera si strategji për suksesin në luftë.

Si të simulosh një Gjykim të Krimeve kundër Njerzimit, në lidhje me Gratë.

1. U thoni nxënësve që do të studiojnë dhe analizojnë raste në të cilat dhuna dhe krimet ndaj grave janë quajtur si krime kundër njerzimit dhe mbasi tu thoni disa raste atyre, duhet të zgjidhni një për ta analizuar.
 - a. Krime gjinore të kryera në ndonjë nga luftrat në vijim; Lufta e Vietnamit ne 1970, Lufta civile në Salvador 1980, Rregullat e talibanëve në 1990 në Afganistan.
 - b. Krimet kundër grave ne Greqi gjatë diktaturës ushtarake në 1070, në Kili ose Argjentinë.
 - c. Krime të kryera kundër grave në vende që kane qënë shumë kohë nën regjime ushtarake të huaja si Filipinet, Korea e Jugut, Okinava.
2. U ndani detyra specifike në punën kerkimore. Bëni një listë me burimet e informacionit dhe i ndani ato sipas grupeve.
3. U jepni një kohë siç mund të jenë tre orë mësimi për tu mbledhur dhe diskutuar mbi rezultatet e kërkimit, duke i vënë rëndësi ideve dhe gjetjeve në këto fusha.
 - 3.1 Situata historike në të cilat këto krime kanë ndodhur.
 - 3.2 Personat e ndryshëm dhe grupet që kishin marrë pjesë.
 - 3.3 Natyra e krimit
 - 3.4 Te Drejtat e Njeriut dhe standartet e Ligjit Internacional të thyera gjatë kësaj situatë
 - 3.5 Kur ti vij fundi bisedës vendosni që;
 - a. Kush u akuzua për këto krime
 - b. Kush e çoi ne Gjykatë këtë krim
 - c. Kush janë viktimat e rastit
 - d. Kush do të jenë dëshmitarët që do të dëshmojnë rreth kësaj ngjarjeje
4. I ndani rolet për simulimet si më poshtë:
 - 4.1 Gjykatësit, të cilit do të përdorin ligjin Internacional dhe formulojnë një gjykim final për këtë rast
 - 4.2 Kush do të jetë Prokurori i cili me materialet e mbledhura do të akuzojë fajtorët
 - 4.3 Këshilltarët e mbrojtjes, njerzimit të cilit do të interpretojnë ligjet dhe do japin këshilla mbrojtjes.
 - 4.4 Dëshmitarët të cilët do të thonë ato që dinë në lidhje me këtë rast
 - 4.5 Të akuzuarit, ata të cilët akuzohen për këto krime të kryera.
5. U jepni një periudhë kohe për tu përgatitur.
 - 5.1 Prokuratorët duhet të kenë gati akuzën dhe të jenë gati ta provojnë atë.

- 5.2 Të gjitha skuadrat e tjera duhet të jenë gati për te luajtur rolet e tyre.
6. Mbasi të jenë treguar faktet dhe të jenë dëgjuar dëshmitarët, mbrojtja dhe akuza do të flasin me rradhë për të mbrojtur palën e tyre.
- 6.1 Gjykatësit duhet të krijojnë një mendim në lidhje me atë që po prezantohet.
- 6.2 Mediat duhet të përgatisin raportet që do i kalojnë shtypit
- 6.3 Specialistët dhe njerëz të tjerë të interesuar do të paraqisin mendimin e tyre të kualifikuar në lidhje me këtë çështje.
7. Gjykatësit duhet të japin një vendim final në bazë të të gjithave standarteve ligjore
8. Diskutoni mbi të gjithë këtë gjyq dhe shihni rëndësinë e gjykatës internacionale në lidhje me dënimin e krimeve kundër Njerzimit.
9. Filloni një debat në lidhje me mbështetjen dhe ndihmën që i duhet dhënë Gjykatës Internacionale.

Sipas dëshirës: Shihni kasetën e Gjyqit të Tokios dhe vendimin e marrë dhe pastaj i krahasoni ato me vendimin e marrë prej jush.

Kapitulli i Dytë:

Ndihma Humanitare,

Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 12

RASTI I WANGARIT

Shoqëria civile lulëzoi që mbas mbarimit të luftës së dytë botërore. Ky ishte një sukses i madh sepse njerëz të thjesht filluan të mësojnë dhe të venë në punë organizma të mëdhaja për mbrojtje të të drejtave të njeriut, asistencë humanitare çarmatimi, zhvillimi etj.

Thirrja i Hagës, Preambula, fq 3.

Shumë shoqëri kanë në historinë e tyre heronj dhe heroina. Në këtë rast ne do të flasim për një grua keniane e cila dedikoi jetën e saj në zhvillimin e vendin të saj. Ajo duke u lidhur dhe me

grupe të tjera kryen punë dhe nisma që të gjithë ne i shohin rezultatet. Brezi i Gjelbër është një nga lëvizjet më të mëdhaja aktuale botërore.

Marrë nga; E adoptuar nga Richard P.Claude, Brezi i Lirisë, Etiopia. Lëvizja e shoqatave profesionale në bashkëpunim me shoqatën për të drejtat e njeriut. Nju Jork, 1996, fq 27-28. Ky është një leksion që përdoret për trajnimin e të drejtave të njeriut në Etiopi.

Mosha dhe Subjekti: Femijë të klasave nga 9 deri në 12.

Materiale: Kaseta të dëgjueshme qart dhe kopje të “Të rastit Wangari-t ”

Metoda; Rast studimi, diskutime, mendime ndërmjet grupeve.

Koncepti; Drejtësi, të drejtat e njeriut, aktivizëm, probleme gjinore.

Objektivat; Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të kuptojnë për nevojën se njerëzit duhet të punojnë për të mirën e përgjithshme
- Të rrisim përpjekjen për të kërkuar të drejtat tona edhe pse do të hasin shumë vështirësi mos reshtni kur së provuari.
- Studioni rastet e stereotipizimit dhe të problemeve gjinore në dritën e diferencave gjinore.
- I zhvilloni problemet sociale si pjesë e të drejtave themelore të njeriut dhe të mësojnë kërkimin e të drejtave ndërmjet lëvizjeve personale dhe shoqërore.

Hapi 1. U kërkoni studentve të tregojnë eksperiencat e tyre personale në lidhje me padrejtësitë sociale në zbatimin e ligjit. I pyesni për raste të tjera padrejtësish gjinore, presionit social kundër ndihmës në komunitet etj.

Hapi 2. U thoni studentve që tani do të hasin një histori për një heroinë të vërtetë.

Rasti i Wangari-t

Në qershor të vitit 1977, Wangari Maathai mbolli 7 pemë në kujtim të heronjëve të Kenias. Mbasi bëri këtë ajo mori nismën për të krijuar një lëvizje të cilën e quajti “Brezi i Gjelbër”. Në vitin 1992 kjo lëvizje me mbi 50 mijë gra nga e gjithë bota kishte mbjell 10 milion pemë. Sot kjo lëvizje ka antarë në çdo vend të botës përfshi dhe Etiopinë. Gjithashtu Kombet e Bashkuara e kanë nderuar me një cmim për punën e tyre. “Brezi i Gjelbër” mbjell pemë për të parandaluar shkretëtirën, pemë dekorative dhe gjithashtu dhe pemë që sjellin të ardhura për banorët e asaj zone.

Në ditët e sotme Wangari dhe “Brezi i Gjelbër” po bëjnë një punë shumë të mirë dhe u thonë të gjithëve se është e pamundur të luftosh për ambientin pa u futur në konflikt me pushtetarët. Sipas

mendimit të saj një lëvizje ambientaliste duhet të jetë pjesë e lëvizjes pro-demokraci në Kenia. Ajo ndihmon njerëzit për të programuar dhe parandaluar ndonjë katastrofë në pronat e tyre dhe gjithashtu koordinon dhe ndihmën që Kombet e Bashkuara i japin këtyre vendeve për këto çështje.

E lindur në 1940, Wangari gjithnjë ka qënë e interesuar për promovimin e ndryshimeve në vendin e saj. Ajo gjithashtu ka qënë dhe femra e parë që u bë profesoreshë e biologjisë në këtë vend. Ajo është dhe nënë e 3 fëmijëve por burri e ka lënë për shkak të aktivitetit të saj. Gratë me influencë që tregojnë një forcë në aktivitetin e tyre gjithnjë gjejnë probleme në rrugën e tyre. Në vitin 1989 Wangari filloi të kritikojë qeverinë Keniane duke filluar një protestë të fuqishme kundër vendimit të presidentit për të ndërtuar një ndërtesë 60-katëshe dhe gjithashtu dhe një statujë 4 kate të lartë të vetes së tij dhe e gjithë kjo në mes të parkut të qytetit. Ajo i bindi donatorët të ndërprisnin fondin e tyre dhe gjithashtu që këtë sipërfaqe toke ta gjenin jashtë qytetit. Në këtë mënyrë ajo u dha mundësi trëndafilave të vazhdonin të rriteshin dhe të eksportoheshin.

Hapi 3. Diskutoni me klasën këtë rast. U thoni studentëve se këto njerëz përpiqen të bëjnë diçka për të mirën e përgjithshme. U thoni që kjo është një histori e vërtetë e një personi që dhe sot vazhdon aktivitetin e vet.

Hapi 4. Hapni një diskutim për të gjetur dhe treguar gjithë gjërat e padrejta që i ndodhen Wangarit. A e tregojnë këto padrejtësi mangësinë e ligjit ? A janë të lidhura këto me të drejtat e njeriut?

Hapi 5. I pyesni studentët se si duan që ky rast studimi të mbarojë? A është e mundur që këto gjëra të ndodhin dhe në vendin tuaj? I pyesni se në qoftëse Wangari do të ishte banore e shtetit tuaj si ju mund ta ndimoni atë në punën e saj.

Hapi 6. Uluni reth e për qark dhe pastaj secili student me rradhë duhet të tregojë emocionet, opinionin dhe gjithçka që mendon në lidhje me këtë çështje.

OPCIONALE

U thoni studente të bëjnë një punë kërkimore për të gjetur historitë dhe punën që kanë bërë këto njerëzit më poshtë për të lidhur çështjet e mjedisit me përgjegjësinë qytetare, të drejtat e njeriut, paqen etj.

- Rachel Carson (USA) autorja e “Pranverë e heshtur” që na lajmëron për rrezikun ambiental që vjen nga përdorimi i pesticideve në bujqësi.
- Helen Caldicott (Australi) autorja e veprës “” Nëse ju e doni këtë planet” dhe “Një plan për të shëruar tokën” që dëshmon për dëmet ekologjike nga përdorimi i armëve bërthamore.
- Vandana Shiva (India) autorja e veprës “Të jetosh” që na tregon për zhvillimin në agro-biznes, çështje militare, probleme gjinore dhe të drejtat ekonomike të të varfërve.

- Chico Mendes (Brazil) i ka kushtuar jetën e tij ruajtjes së pyjeve që prodhojnë kauçuk në pyjet e mëdha braziliane.
- Ken Saro-Wiwa (Nigeri) themeluesi i shoqatës së fshatarve të varfër të cilët u zhvendosën nga tokat e tyre nga kompanitë e mëdhaja të naftës.

Kapitulli i Dytë:

Ndihma Humanitare, Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 13

Loja e Shkëmbimit

“Na lejoni ne të gjithëve të shkëmbejmë ekspserienat tona, solidaritetin dhe dëshirën për të mësuar në të vërtetë në bazë të shkëmbimit ndër brezash, duke pasur një respekt të ndërsjelltë, besim dhe shumë përgjegjësi”

Akhenda e Hagës, rekomandimi 35, fq 37.

Ky ushtrim është në funksion për të ndihmuar studentët që të kuptojnë më mirë njëri tjetrin dhe të ndërtojnë relacione në bazë të besimit dhe të vlerësimit për njëri tjetrin. Konfliktet ndonjëherë ndodhin sepse njerëzit keqkuptohen dhe nuk dinë saktësisht atë që të tjerët duan të bëjnë. Për të ndaluar përshkallëzimin e konfliktit dhe zgjidhjen e tij të dhunshme, bashkëpunimi është shumë i nevojshëm. Të shkëmbesh ekspserienat dhe historitë e tyre është një mënyrë e mirë për studentët që të njihen dhe ta zgjidhin problemin së bashku.

Marrë nga; Ky leksion është përgatitur nga Meg Gardinier, si pjesë e grupit të edukimit në Universitetin e Kolumbias

Mosha dhe Subjekti: cikli i mesëm

Materiale: Klasa me hapsirë të bollshme.

Metoda; Shkëmbimi, tregimi i historive, mësimi masiv, dëgjimi dhe diskutimi

Koncepti; Shkëmbimi, paqja, Bashkëpunimi, jo-dhuna, vlerësimi për të tjerët

Objektivat; Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të tregojnë disa histori që ka diçka speciale për ta në to

- **Të praktikojnë dëgjimin aktiv**
- **Të punojnë së bashku me të tjerët në aktivite krijuese**
- **Të zhvillojnë dhe diskutojnë ide mbi paqen**

Mënyra; Të zhvillohet në disa orë mësimi

Hapi 1. U thoni studentve të sjellin në klasë diçka që është speciale për ta, si për shembull; një lodër, një foto, ushqim apo gjithcka tjetër atyre u pëlqen dhe që duan ta ndajnë me shokët e tyre të klasës.

Hapi 2. U shpjegoni rregullat e lojës studentëve. Në fillin studentët duhet të tregojnë objektet që kanë sjellë. Kur njëri prej studentve është duke treguar historinë e tij në klasë të tjerët duhet të jenë duke e dëgjuar me vëmendje të madhe. Ne duhet ta dëgjojmë me vëmendje sepse duhet të kuptojmë pse për shokët tanë është e rëndësishme dhe kjo është mënyra më e mirë për tu bërë shokë.

Pasi të mbaroj tregimi i parë studentët duhet ti bëjnë pyetje nëse dëshirojnë për të mësuar diçka më shumë në lidhje me këtë histori. Edhe mësuesi mund të filloj një bisedë ku studentët të mësojnë më shumë për njëri-tjetrin

Kur diskutimi të arrij fundin formoni grupe me nga tre veta dhe me objektet që kanë sjellë duhet të krijojnë një tregim për paqen.

Kur të mbaroj dhe kjo pjesë e lojës të gjitha tregimet duhet të lexohen para klasës.

Hapi 3. Mbasi të jenë shpjeguar rregullat, mësuesit dhe studentët duhet të formojnë një rreth ku të fillojnë të tregojnë historitë e tyre. Sigurohuni se çdo njeri ka një vend tek ky rreth dhe ka mundësi të dëgjoj qartë ato që thuhet. Të gjithë studentët duhet të kenë kohë të barabartë në dispozicion.

Hapi 4. Kur studentët të kenë mbaruar së treguari historitë e tyre, mësuesi duhet ti fusi në fazën tjetër të lojës. I pyesni për të treguar ndjenjat dhe emocionet e tyre në lidhje me këto histori.

Mësuesi duhet të shpjegojë që kur njerëzit mblidhen dhe shkëmbejnë me njëri tjetrin ashtu siç klasa bëri tani, e ndihmojnë botën të bëhet një vend me paqedashës dhe i qetë.

Hapi 5. Pastaj u thoni studentve të formojnë grupe me nga tre veta për të krijuar historitë e tyre. Këto histori për paqen duhen të përmbajnë objektet për të cilat u fol më parë. Për shembull, në qoftëse një student ka sjellë fotografinë e mamasë së tij dhe një tjetër një lodër, ata duhet të krijojnë një histori sesi jeta e tyre familjare rrjedh në paqe e mirëkuptim.

I vetmi rregull është që të gjithë studentët në grupe të ndihmojnë në krijimin e historisë.

Përfundime;

Hapi 6. Kur të gjitha grupet të kenë mbaruar historitë e tyre riformoni rethin dhe sigurohuni se të gjithë kanë mundësinë të dëgjojnë.

Hapi 7. Mësuesi duhet tu japi kohë që të gjithë të tregojnë historinë e tyre. Kur ky aktivitet të mbaroj klasa duhet të mblidhet për të folur së bashku se si janë ndier dhe ç'mendojnë për këto histori.

Nëqoftëse studenëtve u ka pëlqyer dëgjimi i historive të tjerëve, bashkëpunimi në grupe dhe kur të tjerët i degjonin, i inkurajoni ata të vazhdojnë lojën e shkëmbimit në shtëpi dhe në vende të tjera ku ata shkojnë. U rikujtoni atyre se shkëmbimi dhe bashkëpunimi është i rëndësishëm në krijimin e një bote paqedashëse.

Kapitulli i Dytë:
Ndihma Humanitare,
Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 14

Si ndodhin dhe zhvillohen konfliktet duke përdorur literaturë për fëmijë

Shoqëria civile duhet të marrë një rol prej lideri për të treguar që parandalimi i konflikteve është i mundur dhe është i preferueshëm – dhe në terma të vlerës së jetës njerëzore dhe vuajtjes, sado kosto të lartë të ketë – duhen marrë masa urgjente.

Akhenda e Hagës, Rekomandimi 30, fq 34.

Si ndodhin dhe zhvillohen konfliktet duke përdorur literature për fëmijë!?

Konfliktet ndodhin dhe zhvillohen. Ato shpesh herë degjenerojnë në dhunë. Por gjithashtu mund të zgjidhen në një mënyrë paqësore. Dhe provokimet gjithashtu mund të parandalohen dhe të evitohet shkallëzimi deri në konflikt. Shumëllojshmëria e konflikteve të jep mundësinë gjithmon që të ketë shumë për të bërë para, gjatë dhe mbas zhvillimit të tij.

Ne kemi detyrën t'ju ofrojmë studentve tanë ngjarje reale dhe jo reale por që janë shumë kualitative dhe shumë mësimdhënëse. Rastet me të mira do ti përdorim për të analizuar konfliktet.

Rastet e konflikteve gjatë studimeve duhen të ndahen në studimin e tyre, zgjidhjen, dhe transformimin. Konfliktet janë dinamike, me shumë dimensione që vazhdimisht ndikojnë tek njëri tjetri. Çdo frazë apo komponent nëse ndërrohet, sjell ndryshime të frazave të tjera dhe të rezultati final.

Duke u bërë gati për të studiuar këtë material konceptet si; parandalim, zgjidhje dhe transformim duhet të lidhen dhe të merren parasysh në bashkëveprim me konceptet e kapitullit 2, librit 1, “Të mësuarit për ndalimin e luftës”.

Marrë nga; Ky mësim është përgatitur nga Janet Gerson dhe Jill Strauss (2001) për një trajnim mësuesish në Universitetin e Kolumbias.

Mosha dhe Subjekti: Shkolla 8 – vjecare, cikli i ulët.

Materiale: Një histori që tregon një keqkuptim, një mosmarrëveshje, një grindje në një relacion social. Një shembull mund të jetë libri “Shtëpia në pemë” shkruajtur nga Lois Lawry, që mund të gjendet tek libri i madh i paqes (Ann Durell and Marilyn Sach, botuar në Nju Jork, 1990)

Metoda; Lexim, refleksion, grupe të mëdhaja dhe të vogla refleksioni.

Koncepti; Parandalimi, mënyra e zhvillimit, analiza, zgjidhja e problemeve, hedhja e ideve të përbashkta për të zgjidhur një konflikt, pajtimi dhe ndërtimi i marrëdhënieve të mira në një relacion social.

Objektivat; Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të mësojnë fazat e zhvillimit të një konflikti
- Të bëjnë pyetje kreative për të gjetur mundësinë e zgjidhjes në rrugë paqësore të konfliktit.
- Një ide e përgjithshme dhe një plan veprimi për një rezultat të mirë final.

MËNYRA;

Pjesa e parë; eksperiencat e tyre me konfliktet.

1. Të gjejnë një definicion të saktë e të plotë mbi konfliktet
2. Pyesni studentët për eksperiencat e tyre me konfliktet duke përdorur pyetjet e fazës së katërt.
3. U thoni atyre që ju do ti kërkoni të shkruajnë diçka reth ekperiencave të tyre.
4. U paraqitni këto pyetje për tu prezantuar një konflikt në proces.

A mbani mend gjatë një konflikti kur?

- a) Kur ju shpresonit të mos ndodhte ky konflikt
- b) Kur konflikti mbaroi ju menduat një mënyrë sesi ti sheshonit diferencat
- c) Kur ju u shqetësuar se s’do të vazhdonit gjatë me një njeri që është i rëndësishëm për ju

- d) Kur ju se dinit mirë seç kishte ndodhur dhe u përpoqët të kuptonit se ç'po ndodhte
 - e) A u zgjidh konflikti?
 - f) Kur ju kërkuaat për ndihmë për të zgjidhur konfliktin tek një i tretë siç është për shembull një mediator, një prift, një mësues apo dikush me moshë të madhe nga familja juaj.
 - g) Kur ju menduat se kush ishte hapi tjetër për tu bërë.
 - h) Kur juve, ju është dashur të bëni ndryshime, gjatë zhvillimit të konfliktit ose gjatë manaxhimit të tij.
 - i) Kur kjo lidhje ishte më mire mbas konfliktit
 - j) Kur konflikti mbaroi çfarë menduat ju se do të ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur atë.
5. Jepni definicionet e konfliktit gjatë procesit dhe i shihni ato në relacion me pyetjet e mësipërme.
 6. U thoni studentve tuaj të shkruajnë rreth një konflikti dhe ti lexojnë shënimet përpara klasës.
 7. I pyesni se në ç'rrethana u ka ndodhur atyre konflikti dhe cilët faktorë social ndikuan tek konflikti i tyre.
 8. Reflektoni se në sa mënyra të ndryshme mund të gjendesh dhe ta zgjidhësh një konflikt

Pjesa e dytë

1. I ndani studentët në grupe të vogla nga 4 ose 5 anëtar. U thoni atyre që do të dëgjojnë një histori mbi një konflikt dhe ti kushtojnë shumë vëmendje, si për të kuptuar tjetrin ashtu dhe për të kuptuar fazat e këtij konflikti që po tregohet.
2. Lexoni me zë të lartë librin “Pema e jetës” ose histori për fëmijë të ngjashme me këtë libër që tregojnë për konflikte të ndryshme. Ndaloni së lexuari gjithmon pak përpara se personazhet të zgjidhin konfliktet e tyre.
3. I pyesni studentët se si ato i kuptuan dhe ç'mendojnë për veprimet që ndërmoren personazhet në këtë histori. U thoni studentve që duhet të përdorin ndjenjat e tyre dhe atë që ata kujtojnë nga procesi i analizës së konflikteve të mëparshëm dhe tu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme. Çdo grup duhet të zgjedh një student të mbaj shënime dhe një tjetër që do ngrihet të flas në emër të të gjithëve.

Kujdes; Këto pyetje mund të adaptohen më mirë tek historitë reale të treguara aty!

- Si mund të mbaroj historia që personazhet të pajtohen dhe miqësia të shkoj përpara
 - Çfarë mund të kishin bërë personazhet më përpara që të parandalonin konfliktin?
 - Çfarë mund të bëjnë ata në të ardhmen?
4. U thoni studentve që idetë e tyre ti ndajnë me të gjithë klasën. Shkruani në dërrasën e zezë mendimet e tyre.

5. Tani erdhi koha të lexoni fundin e tregimit. Krahasoni fundit e tregimit me idetë e shkruajtura në dërrasën e zezë. I pyesni ta krahasojnë zgjidhjen e librit me atë që çdokush kishte në mendje. Dhe i pyesni se si idetë e tyre mund të aplikohen në të ardhmen.
6. Reflektoni mbi përgjigjen dhe përgjigjjuni çdo lloj pyetje që ka të bëjë me konfliktin dhe fazat e tij!

Kapitulli i Dytë:
Ndihma Humanitare,
Ligji mbi të Drejtat e Njeriut dhe Istitucionet

LEKSIONI 15

Vëzhguesit

*Të forcosh kapacitetet lokale është shumë e rëndësishme për ruajtjen e paqes.
Kjo procedurë mund të vihet në jetë duke filluar nga trajnimet, mënyrat e ndryshme të
edukimit, vullnetarizmi etj.*

Akhenda e Hagës, Rekomandimi 28, fq 33.

Vëzhguesit;

Vullnetarët dhe paqeruajtësit lokalë shumë herë e gjejnë guximin dhe kurajon për të ndërmarrë një veprim si rezultat i eksperiencës apo se kanë qënë vëzhgues në raste të tilla. Ky leksion do i ndihmoj studentët të kuptojnë rëndësinë që shpesh herë kanë ato njerëz që ndodhen si dëshmitarë ne vend ngjarje të ndryshme.

Marrë nga; Ky leksion është adoptuar nga “Kreativiteti në Konflikt”, e punuar nga Janne Port-van Eeden dhe Benyamin Yanoov, Hollandë 1999.

Mosha dhe: Shkolla 8 – vjecare, cikli i ulët.

Materiale: Punë mbi vëzhguesit, lapsa dhe letër.

Metoda; Puna në grupe, të zbusësh pasojat e një konflikti gjatë zhvillimit të tij.

Koncepti; Konflikti, vëzhguesit, ndërhyrja.

Objektivat; Studentët duhet të jenë të aftë që;

- Të mësojnë se si vëzhguesit luajnë një rol të rëndësishëm gjatë një konflikti.
- Të zhvillojnë mënyrën e të kuptuarit e rolit që mund të luajnë vëzhguesit gjatë një konflikti.
- Të praktikojnë punën së bashku.

Procedura;

Hapi 1; Synimi i aktivitetit është që; në gjashtë përshkrime të shkurtra të konflikteve studentët duhet të gjejnë dhe vlerësojnë rolin e vëzhguesve.

Hapi 2; U jepni studentve një shpjegim të plotë se ç'rol luajnë shpesh herë gjatë një konflikti vëzhguesit. Gjatë një konflikti palët mund të fillojnë të luajnë një rol më të fortë vetëm për të treguar para vëzhguesve forcë dhe për ti bërë reklamë vetes. Dhe gjithashtu në shumë raste vëzhguesit mund të ndihmojnë të zbusin pasojat dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit.

Hapi 3; U thoni studentëve se do të studiojnë 6 skenat e ndryshme dhe rolin që luajnë vëzhguesit në një konflikt. U jepni shembujt e mëposhtëm studentve dhe u thoni se në përshkrimet 1, 3 dhe 5 vëzhguesit kanë luajtur një rol negativ dhe në përshkrimet 2, 4 dhe 6 kanë luajtur një rol pozitiv.

Hapi 4; I ndani studentët në grupe me nga 2 veta. Ata duhet të fillojnë të studiojnë të 6 rastet dhe të fillojnë të diskutojnë mbi to dhe për rolin që kanë luajtur vëzhguesit në konflikt. A kanë kontribuar ata për mirë apo për keq. Çdo student duhet të shkruaj idenë e tij në lidhje me çdo konflikt.

Hapi 5; Diskutoni me klasën mbi atë që ato kanë shkruajtur.

- a) Cili është rezultati i reagimit të vëzhguesve?
- b) Në çfarë mënyre tjetër vëzhguesit mund të influencojnë në një konflikt? A dinë studentët shembuj?

Hapi 6; U jepni studentve të kuptojnë se shpesh herë palët në konflikt i shfrytëzojnë vëzhguesit në interes të tyre, për tu treguar me të sigurtë dhe më të fortë.

Diskutim

- A. Cilat janë konsekuencat e një konflikti në prezencën e vëzhguesve?
 - A bëhen palët në konflikt më fanatike ndaj njëra tjetrës?

- I ndani palët dhe u vini në dispozicion nga një dhomë për të reflektuar. Sepse kur jeni në mes të një konflikti ju e keni të pamundur të reflektoni mbi zgjidhjet.
- Kur qeshet në një konflikt palët ashpërsohen dhe mbajnë qëndrime më të egra. Psh kur qeshni gjatë orës së mësimit dhe mësuesja është gjatë zgjidhjes së një problemi, konflikti bëhet më i ashpër dhe zgjidhja më e vështirë.
- Kur vajza e vogël ikën me vrap duke qarë – ka mundësi që mos ta ketë aprovuar konfliktin – këtu ka dhe një mundësi që Wim të mos të jetë përgjigjur ndryshimeve.
- Nëse gjatë një konflikti I jepet kurajo vetëm njërës pale, pala tjetër friksohet dhe konflikti vazhdon më gjatë.
- Kris i ndalon të tjerët dhe i vë ato të mendojnë. Kjo është faza e parë e zgjidhjes së konfliktit.

B. Vëzhguesit mund të ashpërsojnë një konflikt duke;

- Të qeshin me veprimet e njërës palë.
- Të irritojnë dhe të ngacmojnë palët në konflikt.
- Të ndërhyjnë në konflikt dhe vetë personalisht të fillojnë të zihen.

C. Vëzhguesit mund të ndihmojnë të lehtësojnë një konflikt duke;

- Duke ndarë palët.
- Duke treguar mos-aprovimin e tyre dhe të përpiqen të miqësojnë situatën.
- Duke i lënë palët vetëm dhe mënjanë njëri-tjetrit.
- Duke eleminuar shkakun e konfliktit.

Gjashtë rastet janë si më poshtë;

- Dy djem janë duke u zënë dhe shokët bërtasin “jepi, më fort etj”
- Dy goca po i shkulin flokët njëra tjetrës dhe ato i ndajnë
- Një studente bëri një shaka në klasë dhe tani e gjithë klasa po qesh. Mësuesja tani po bëhet më e ashpër.
- Kur dy djem po zihen dhe motra e vogël e njërit prej tyre ikën më vrap
- Gerti po thërret: “Jessy e vogël...” Të tjerët po qajnë duke u tallur “Jessy është një vajzë e vogël”
- Dy shoqe po zihen për lojën e tyre. Një mik i tyre i pyet “Çfarë kërkon ju në fund të fundit”?

Kapitulli i Tretw:
Parandalimi, Zgjidhja dhe Transformimi i Konflikteve të

Dhunshme

Leksioni 16

Klasat e Mesme

“Mundësia e rinisë për të marrë pjesë në ndërtimin e paqes është thelbësore për të thyer ciklin e dhunës, për të ulur dhe evituar konfliktin.”

- *Axhenda e Hagës, Rekomandimet 35, f. 37*

- **Përballja e Perspektivave të Kundërta:**

Roli i Rinisë në Konflikt

Ushtrimi në vazhdim synon që të ndihmojë nxënësit që të konsiderojnë kompleksitetin e perspektivave të kundërta që ndihen thellësisht dhe që shpesh shkallëzohen në ekstremizëm, diskriminim, konflikt të dhunshëm, dhe luftë. Duke kuptuar se çfarë lloj perspektivash çojnë drejt shprehjes së dhunshme të konfliktit, studentët fillojnë të konsiderojnë alternativat jo të dhunshme dhe perspektivën e tretë mjaft të rëndësishme, atë të interesave të përbashkëta. Është shpesh rinia që shërben si instrument për të sjellë këto perspektiva bashkuese në vëmendjen e komuniteteve të tyre.

Burimi: Adoptuar nga Sanaa Osseiran, *Handbook Resource and Teaching Material in Conflict Resolution, Education for Human Rights, Peace and Democracy (Doracak Burimor dhe Material Mësimor në Zgjidhjen e Konflikteve, Edukimin për të Drejtat e Njeriut, dhe Demokraci)*, i publikuar nga Qendra Edukimore për Kërkim dhe Zhvillim, Bejrut, Liban, në bashkëpunim me Shoqatën për Kërkime Ndërkombëtare për Paqe dhe UNESCO, 1994, f.29.

Niveli Klasor dhe Lënda:

Klasat e mesme, studimet shoqërore, histori, çështjet moderne.

Materiallet: Dërrasë e zezë, shkumës, letra, stilolapsa, fletë të mëdhaja letre, markera, dhe flipçarte; artikuj gazetash ose filma dokumentarë; piktura

Metodat: Stuhi idesh; luajtja e roleve; diskutimet në grup ose dialogjet; analizimi i lajmeve.

Konceptet: Konflikti jo i dhunshëm, alternativat përveç luftës, drejtësia shoqërore.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ **Marrin në konsideratë faktin se ekzistojnë shumë perspektiva të ndryshme mbi një çështje të vetme, dhe se çdo grup ka të drejtën të ketë perspektivën e vet;**
- ◆ **Ushtrojnë dialogun për të ndërmjetësuar ndryshimet dhe për të arritur në një kompromis dh/ose një marrveshje dyanësisht të kënaqshme.**

Procedura;

Fillimi i diskutimit:

Hapi 1: Mësuesi organizon një lojë rolesh ku pesë studentë transmetojnë të njëjtin lajm nëpërmjet burimesh të ndryshme mediash (Stacione TV). Transmetimet do të ndryshojnë në varësi të perspektivave të të burimeve të ndryshme mediatike, psh, ndryshe nga njëri stacion tek tjetri.

Aktiviteti dhe përgatitja e diskutimi:

Hapi 2: Mësuesi thërret një diskutim rreth perspektivave mbi të vërtetën dhe realitetin. Mësuesi duhet të vërë re relativitetin e perceptimit të çështjeve dhe të nxjerrë mirë në pah se mënyra se si dikush kupton zgjidhjet e shumta të një problemi shpesh reflekton një ndryshueshmëri të tillë dhe, me raste, perspektivat konfliktuale, veçanërisht kur trajtohet një shoqëri me bashkangjitje, pikëpamje, dhe besime të shumta.

Hapi 3: Mësuesi duhet të tregojë se gjatë çdo lufte seicila nga palët shpesh mendon se ka të drejtë, dhe se kjo lloj sjellje shpesh shkallëzon konfliktin duke çuar në ekstremizëm, dhunë, dhe luftime. Mësuesi mund të jap shembuj të tanishëm apo historik të sjelljeve të tilla, dhe të kërkojë të tillë shembuj nga nxënësit. Pasi shembujt të jenë marrë konsideratë, mësuesi mund të fillojë të analizojë perspektivat që ndihmuan konfliktin në seicilin nga rastet.

Hapi 4: Preferohet që mësuesi të sjellë burime lajmesh rreth një ngjarjeje politike apo ekonomike të cilat tregojnë pikëpamje të ndryshme dhe që mund të luhen dhe të mbrohen si të vlefshme nga studentët në luajtjen e roleve.

Hapi 5: Mësuesi paraqet temën e rolit të rinisë në një botë me konflikte. Si është të rritesh në një atmosferë të karakterizuar nga ekstremizmi, dhuna, dhe aderimi i ngushtë tek feja dhe besimi? Çfarë roli mund të luajnë të rinjtë? Mësuesi i kërkon nxënësve të imagjinojnë dy parti opozitare që besojnë seicila se kanë në dorë vërtetësinë përfundimtare të situatës. Seicila prej tyre beson se ajo ka të drejtë dhe se tjetra e ka gabim. Diskutoni me studentet zgjidhjet e mundëshme, negociimet, perspektivat alternative, apo marrëveshjet e mundëshme që mund ti japin fund këtij konflikti pa pasur rezultatet shkatërrimtare dhe negative të një përfundimi fitore/humbje.

KONKLuzionet:

Hapi 6: Mësuesi lidh rezultatin e këtij dialogu klase me nocionin e perspektivave alternative, dhe me të drejtën e seicilës parti për të pasur perspektivën e vet. Sidoqoftë, në një komunitet të përbashkët, ka gjithmonë një perspektivë të tretë: Ne. Në pozicionin “Unë kam të drejtë dhe ti e ke gabim”, nuk ekziston “ne”. Në mënyrë që të arrihet tek një kompromis apo një marrëveshje dyanësisht e kënaqshme, palët konfliktuale duhet të fillojnë të njohin jo vetëm perspektivën e tyre por edhe atë të “armikut” të tyre, por gjithashtu edhe perspektivën e kujtdo plani të përbashkët që mund të ekzistojë dhe në të cilin ata kanë interes.

Hapi 7: Nëse keni dëshirë, eksploronit me klasën se cilat janë implikimet e konfliktit, atij të dhunshëm apo jo të dhunshëm, çfarë do të ishte nëse seicila palë do të njihte perspektivën e tretë të “ne”.

Kapitulli i Tretw:

Parandalimi, Zgjidhja dhe Transformimi i Konflikteve të

Dhunshme

Leksioni 16

“Fushatat e Shoqërisë Civile kanë krijuar bashkim dhe integrim dhe kanë demonstruar atë që mund të bëhet kur njerëzve u merret mendimi në vend që tu jepet mendje.”

- Axhenda e Hagës, Preambula 9, f. 3

MËSIMI I TË DËGJUARIT

Aftësitë e të dëgjuarit janë domethënëse në të gjitha lidhjet njerëzore dhe absolutisht esenciale në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Zhvillimi i aftësive të mira të dëgjimit duhet të jetë një qëllim prioritar i të gjithë edukimeve, sidomos i edukimit civil dhe edukimit për paqes. Linjat drejtuese, në faqen në vazhdim, nga Ron Kraybill i Universitetit Lindor Menonit (SH.B.A.) japin bazën për zhvillimin e aftësive të tilla.

Burimi: Ky material u adoptua nga një libër i shpërndarë në Takimin Vjetor të Shoqatës të Studimeve të Paqes në Shtetet e Bashkuara.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e mesme, çdo lëndë ku përdoret diskutimi dhe shkëmbimi verbal në klasë.

Materialet: Përshkrim i shkurtër i konflikteve apo situatave që mund të prodhojnë konflikte, dhe që përfshijnë dy palë apo dy persona opozitarë.

Metodat: Analiza e konfliktit; të folurit mbi perspektivat; dëgjimi aktiv.

Konceptet: Komunikimi konstruktiv, respekti për perspektivat dhe opinionet e kundërta.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ Mësojnë të krijojnë një ambjent mbështetës që i ndihmon njerëzit të qetësohen dhe të përqëndrohen tek çështjet;
- ◆ Zhvillojnë raporte dhe besim me të dyja palët në një mosmarrveshje apo një konflikt;
- ◆ Praktikojnë transmetimin e simpatisë dhe respektit për çdo person, pamvarësisht nga besimi, fjalët apo sjellja e tyre;
- ◆ Demonstrjnë një aftësi për të treguar qartësisht problemet bazike që duhet të zgjidhen në forma problemesh dhe çështjesh, dhe jo në formë personalitetesh.

PROCEDURAT:

Hapi 1: Shpërndarja e linjave drejtuese (materiali në faqen numër 7) klasës.

Hapi 2: Pasi ato të jenë lexuar me kujdes, pyesni nëse studentët kanë nevojë për ndonjë sqarim.

Hapi 3: Pasi jeni siguruar se klasa i ka kuptuar linjat drejtuese, formoni grupe me nga tre studentë për grup për të praktikuar aftësitë dëgjimore.

Hapi 4: Jepini seicilit grup nganjë përshkrim të shkurtër konfliktit. I kërkoni dy studentëve që të zgjedhin pozicionet, perspektivat prej të cilave ata do të flasin, dhe caktoni një student si ndërmjetës. (I përgatisni konfliktet në mënyrë që ata të përshkruajnë një çështje apo problem me dy pozicionet kundërshtarë në konflikt. Këto mund të jenë të vërteta ose hipotetike.)

Hapi 5: I drejtoni ata që kanë marrë pozicione që të prezantojnë çështjet e tyre përpara ndërmjetësit dhe që ndërmjetësi që dëgjojë seicilin nga folësit, duke ndjekur linjat drejtuese.

Hapi 6: Lajmëroni 12 minuta për fazën e parë, duke lejuar 4 minuta për seicilin që të prezantojë pozicionin e vet dhe 4 minuta për ndërmjetësin që të bëjë pyetjet, bëni përmbledhjen, dhe i bëni palët ndërkonfliktuese që të bien dakort me përmbledhjen.

Hapi 7: I drejtoni grupet që të ndërrojnë përshkrimet e konflikteve me grupet e tjera.

Hapi 8: Përsëriteni prapë procesin.

Hapi 9: Bëni edhe një ndërrim konfliktesh dhe përsëriteni procesin në mënyrë që të 3 studentët në seicilin nga grupet të ketë luajtur një herë rolin e ndërmjetësit.

Hapi 10: Bëni përmbledhjen, duke ngritur pyetje mbi atë çfarë studentët mësuuan në proces dhe çfarë ata nevojitet të zhvillojnë më tej për tu bërë dëgjues të mirë dhe potencialisht ndërmjetës të mirë.

Hapi 11: Vini theksin në faktin se, për të parandaluar shkallëzimin e konfliktit në të gjitha sferat e jetës, dëgjimi i vëmendshëm aktiv duhet që të praktikohet.

MATERIAL PËR SHPËRNDARJE

LINJAT DREJTUESE PËR NJË DËGJIM EFEKTIV

KATER MËNYRA PËR TË DËGJUAR EFEKTIVISHT

1. Përdoreni trupin tuaj në mënyre që të tregoni se po dëgjoni.
 - ◆ Mbani kontant të vazhdueshëm me sytë e personit që flet
 - ◆ Pohoni duke tundur kokën
 - ◆ Orientohuni me trupin tuaj drejt folësit (koka, krahët, këmbët)
 - ◆ Thoni shprehje si “aha”, “po, po”, “e shoh”, etj.
2. Përdorni “përgjigjet eko”, duke përsëritur fjalën apo shprehjen e sapothënë nga folësi. Kjo gjë drejtpërsëdrejti fokuson vëmendjen e folësit tek gjërat që mund të jenë të paqarta për ty. “Përgjigjet eko” ju lejojnë të drejtoni rrjedhjen e bashkëbisedimit pa ndërprerje të mëdhaja.
3. “Perifrazoni” apo thoni edhe një herë ato që folësi ka thënë por me fjalët e tuaja. Kjo është një aftësi themelore që kërkon praktikë.
 - a) Fokusohuni tek folësi. “Ti...”
 - b) Përfshini si **faktet** ashtu edhe **ndjenjat**. Gjuha e trupit dhe toni i zërit do t’ju çojnë ju tek ndjenjat.
 - c) Një perifrazim nuk përmban asnjë lloj gjykimi apo vlerësimi, por thjesht **përshkruan me simpati**.
 - ◆ “Pra ju me të vërtetë mendoni se...”
 - ◆ “Mënyra se si ju e shihni atë...”
 - ◆ “Ju nuk ishit aspak i kënaqur kur ai...”
 - ◆ “Ju u ndjetë shumë i mërzhitur me fqinjin tuaj në atë situatë...”
 - ◆ “Nëse po të kuptoj tamam, ti...”
4. **Përmbliidni** pikëpamjet kryesore të folësit pasi ti keni dëgjuar ato. Një përmbledhje është një rithënie e zgjeruar e pikave kyçe të informacionit të ofruar nga folësi. Përdoreni përmbledhjen për të fokusuar thëniet e çdo pale në terma **çështjesh** dhe **problemesh të zgjidhshme**,

në vend të personliteteve. Në përmbledhjen finale, merrni miratimin e folësit të cilin ju e keni përmbledhur si saktësisht ashtu edhe plotësisht.

Kapitulli i Tretw:

Parandalimi, Zgjidhja dhe Transformimi i Konfliktëve të Dhunshme

Leksioni 18

“Shumë shpesh, konflikti i dhunshëm “zgjidhet” nga faktorë të jashtëm me pak ose aspak referim tek dëshirat e atyre që do të jetojnë me këtë zgjidhje... Nëse përpjekjet për të parandaluar, zgjidhur dhe transformuar konfliktin e dhunshëm duan të jenë efektive në një periudhë afatgjatë, ata duhet që të bazohen në pjesëmarrjen e fortë të grupeve të shoqërisë civile të përkushtuar në ndërtimin e paqes.”

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 9, f. 33

TË MENDUARIT RRETH KONFLIKTIT

Në mënyrë që studentët të kuptojnë konceptin e konfliktit si një proces, ashtu siç është përkufizuar në planveprimin konceptual të diskutuar në Kapitullin 2, ata duhet të fillojnë me disa përkufizime dhe përshkrime konceptuale të marra nga burime të besueshme dhe të jenë të aftë të formulojnë përkufizimet e veta të punës.

Burimi: Adoptuar nga Sanaa Osseiran, *Handbook Resource and Teaching Material in Conflict Resolution, Education for Human Rights, Peace and Democracy (Doracak Burimor dhe Material Mësimor në Zgjidhjen e Konfliktëve, Edukimin për të Drejtat e Njeriut, dhe Demokraci)*, i publikuar nga Qendra Edukimore për Kërkim dhe Zhvillim, Bejrut, Liban, në bashkëpunim me Shoqatën për Kërkime Ndërkombëtare për Paqe dhe UNESCO, 1994, f.7-8.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e mesme, studimet shoqërore, histori, çështjet moderne.

Materialët: Materiali për shpërndarje në klasë “Të menduarit rreth konfliktit” që gjendet në fund të njësisë; artikuj gazetash, markera, kaseta, fjalorë.

Metodat: Leximi; reflektimi; diskutime në grupe të vegjël dhe të mëdhenj; citimi i shembujve të karakteristikave, formimi i përgjithësimeve.

Konceptet: Konflikti, procesi, pasojat e zgjedhjes, jo-dhuna, citimi i burimeve.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ Përkufizojnë, përshkruajnë, dhe dallojnë midis konfliktit konstruktiv dhe destruktiv;
- ◆ Mësojnë rëndësinë e të cituarit ashtu siç duhet të burimeve në kërkimet që bëjnë;
- ◆ Rradhisin karakteristikat dhe pasojat e konfliktit;
- ◆ Rrisin kuptimin e konfliktit si një proces;

PROCEDURAT:

Hapi 1: Shpërndani materialin për shpërndarje, “Të menduarit rreth konfliktit” (shikoni në fund të njësisë).

Hapi 2: Shpjegoni se ne duhet të kuptojmë që konflikti haset në jetën tonë gati çdo ditë, dhe prandaj duhet që ne gjithashtu ta kuptojmë konfliktin.

Hapi 3: I kërkoni studentëve që të bëjnë leximin, dhe pastaj të ulen dhe të mendojnë qetësisht rreth asaj që ata kanë lexuar, duke reflektuar mbi aspektet pozitive dhe negative të konfliktit.

Hapi 4: Pas periudhës së meditimit dhe reflektimit, i kërkoni studentëve që të japin idetë e tyre rreth konfliktit. Pyesni: çfarë na tregoi leximi neve? A i përngjan ky përshkrim eksperiencave tona?

Hapi 5: Më vonë i kërkoni studentëve të punojnë në grupe të vogla diskutimi për dy kategori; një pjesë e grupeve të rradhisë aspektet negative të konflikteve, dhe grupi tjetër të rradhisë aspektet pozitive. I jepni çdo grupi një tabak të madh letre dhe markera që të shkruajnë listat e tyre, që më vonë do të vendosen në tabelat apo muret e klasës.

Hapi 6: Kur listat të jenë të përfunduara, i vendosni ato rreth e përçark klasës dhe ftoni studentët që të lëvizin nga njëra listë tek tjetra, duke i lexuar e duke i krahasuar ato.

Hapi 7: Kur studentët të jenë kthyer në vendet e tyre, i pyesni nëse ata të gjithë i kuptojnë ato gjëra që ka rradhitur secili grup. Nëse ka pika që kanë nevojë për sqarim, i lejoni atyre që i kanë shkruajtur ato lista që të sqarojnë atë që kanë shkruajtur.

Hapi 8: Më vonë mbani një diskutim me gjithë klasën për të arritur një marrëveshje mbi një listë aspektesh pozitive dhe një listë aspektesh negative që ata do të përdorin në studimin e tyre të përbashkët të konfliktit.

Hapi 9: I kërkoni studentëve që të konsultojnë fjalorë të ndryshëm dhe të shkruajnë përkufizime të konfliktit që ata gjejnë, duke shënuar apo “cituar” burimin/fjalorin përkatës. Shpjegoni qëllimin dhe rëndësinë e citimit të burimeve për përkufizimet dhe faktet që do të përdoren në studime dhe kërkime.

Hapi 10: Mbani një diskutim mbi përkufizimin e konfliktit pasi studentët të kenë lexuar përkufizimet që ata kanë gjetur dhe pasi të kenë raportuar burimet. I kërkoni atyre të formulojnë me fjalët e tyre një përkufizim të konfliktit që të cilin të gjithë e pranojnë si domethënien që ata do të kuptojnë në studimin e lëndës dhe në diskutimet mbi konfliktin.

MATERIAL PËR SHPËRNDARJE

TË MENDUARIT RRETH KONFLIKTIT

Një mënyrë për të përshkruar paqen është mungesa e dhunës. Ekzistojnë ndryshime ndërmjet njerëzve dhe grupeve, dhe konflikti lind prej përgjigjeve të gjeneruara nga fërkimi që këto ndryshime krijojnë. Procesi që paqja u sjell këtyre situatave i ndihmon njerëzit që të zgjidhin këtë fërkim dhe konflikt nëpërmjet mjeteve jo të dhunshme. Konflikti ekziston në një botë paqësore, por sjelljet që paqja krijon dhe proceset që ajo jep, kanalizojnë në drejtime konstruktive sjelljet agresive të cilat përbëjnë një pjesë shumë të madhe të aktivitetit njerëzor.

Sidoqoftë, pse duhet të ekzistojë konflikti në një botë paqësore? Një përgjigje e pjesshme qëndron në rreshtat e mëposhtëm:

1. Njerëzve u mungon informacioni i kompletuar në botën tonë jo perfekte. Kur bëjmë zgjedhje apo marrim vendime, ne me të vërtetë njohim vetëm situatën tonë dhe prandaj ne vazhdimisht veprimë në mënyra që bien në konflikt me qëllimet, vendimet, dhe veprimet e të tjerëve.
2. Konflikti mund të ekzistojë pjesërisht edhe sepse, me presionin e kohës në jetët tona, ne fokusohemi pikësisht tek interesat, vlerat, dhe nevojat tona, duke anashkaluar e lënë mënjanë ato të të tjerëve me të cilët ne ndërveprojmë.
3. Një arsye e tretë se përse konflikti ekziston është se konflikti në vetvete mund të jetë një proces konstruktiv dhe fitimprurës për shoqërinë njerëzore. Ne mësojmë nga konflikti në mënyra që ne nuk mund të mësojmë nga situata të tjera. Ngandongjëherë eksperiencia është mësuesi më i mirë. Për më tepër, konflikti mund të na motivojë neve që të punojmë në mënyrën më të mirë që dimë, sidomos nën disa kushte specifike kompetitive apo më pak konfrontuese. Konflikti na lajmëron neve për ekzistencën e të tjerëve, interesat, vlerat, dhe nevojat e të cilëve neve duhet të konsiderojmë kur bëjmë zgjedhje dhe kur ndërmarrim veprime. Dhe së fundmi, konflikti na ndihmon neve të identifikojmë kur kërkesat thelbësore njerëzore të dikujt janë të pa përmbushura apo kur mund të ketë mungesë drejtësie apo barazie në shoqëri.

Për fat të keq, konflikti mundet gjithashtu të përmbajë forca shkatërruese që mund të pengojnë ndryshimin, sjelljet paqësore, dhe proceset. Konflikti mund të krijojë frikë, ankth, frustrim, pasiguri, apo emocione të tjera negative të cilat shërbejnë për të drejtuar agresivitetin tonë natyror drejt detyrimit të të tjerëve për t'ju përmbajtur interesave, vlerave, apo nevojave tona pa iu referuar të tyreve. Qëllimet mund të jenë të ndryshme; që prej arritjes së objektivit tonë për të fituar mbi palën

tjetër e deri tek ndëshkimi i të tjerëve kur ata na pengojnë në rrugën tonë. Pushteti bëhet një mjet i përdorimit të dhunës, dhe ndërsa taktikat e lehta hasin në rezistencë, konflikti mund të shkallëzohet drejt përdorimit më të rëndë të forcës dhe përgjigjeve potencialisht më të dhunshme.

Kapitulli 4:

Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore

Leksioni 19

Fjalori i Çarmatimit

“Armët e vogla dhe të lehta si dhe minat e tokës janë një kërcënim shumë i madh për sigurinë njerëzore; përdorimi i tyre sjell si rezultat në pjesën më të madhe të rasteve vdekjen e civilëve dhe e ka bërë më të lehtë shfytëzimin e fëmijëve të vegjël si ushtarë.”

- *Axhenda e Hagës, Rekomandimet 45, f. 44*

FJALORI I ÇARMATIMIT

Kjo njësi përmbush një numër të caktuar qëllimesh të mësimi standart. I pari është zhvillimi i aftësive gjuhësore nëpërmjet përdorimit të fjalorëve dhe enciklopedive për të rritur fjalorin e fëmijëve dhe për të rritur përdorimin e gjuhës krijuese në shprehjen e ideve të tyre. Duke ekzaminuar lidhjen midis efekteve (mikro) lokale dhe (makro) globale të armëve të vogla e të lehta, aftësitë e arsyetimit dhe lidhjes do të rriten. Aftësitë e krijimtarisë dhe shprehjes mund të demonstrohen nëpërmjet përdorimit të shprehive artistike (pikturës) dhe gjuhësore (të folurit dhe të shkruarit).

Kjo njësi mësimore është menduar për të zhvilluar një sensibilizim mbi kërcënimin që armët e vogla dhe të lehta vendosin mbi fëmijët lokalisht dhe globalisht. Këto aktivitete i japin studentëve oportunitetin për të identifikuar dhe për të përshkruar shqetësimet e tyre rreth efekteve që armët e vogla dhe të lehta kanë mbi jetën e fëmijëve në të gjithë botën. Ky mësim gjithashtu synon të zhvillojë sensin qytetar të studentëve dhe përgjegjësitë duke ju bërë atyre të mundur marrjen pjesë në ndërtimin e fushatave publike të sensibilizimit rreth çështjeve që shqetësojnë dhe ndikojnë tek fëmijët. Është qëllimi që duke përdorur *Fjalorin e Çarmatimit* si një mjet mësimi për të mësuar studentët e tjerë rreth çarmatimit dhe sigurisë njerëzore, këto qëllime do të arrihen.

SHËNIM: Kjo njësi mund të përdoret në çift me Njësinë 10 mbi Fëmijët Ushtarë

Burimi: Norma T. Neme, Kolegji i Mësuesve, Universiteti i Kolumbias. Kjo njësi është përgatitur për përdorim në një *Workshop* në Kolegjin e Mësuesve, në Universitetin e Kolumbias, 2001.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat fillore (por e adoptueshme edhe për klasa të tjera): gjuhë/letërsi, studime shoqërore/globale.

Materialet: Fjalorë, enciklopedi, letra për ndërtim, lapsa, pamje nga revistat që tregojnë rrinë dhe dhunën, armë të lehta; lexime të mundëshme për ndërtimin e mësuesve dhe ilustrime që mund të përdoren këtu përfshijnë:

- ◆ *Turbulent Times, Prophetic Dreams: Art from Israel & Palestine Children (Kohë të Turbullta, Ëndrra Profetike: Art nga Fëmijët Izraelitë dhe Palestinezë)*, Harold Kople Koplewicz, Gail Furman dhe Robin Goodman. Publikimet Devora: Shtypur në Izrael, 2000.
- ◆ *One Day We Had to Run: Refugee Children Tell Their Stories in Words and Paintings (Një Ditë na u Dësh të Vraponim: Fëmijët Refugjatë Tregojnë Historitë e Tyre në Fjalë dhe Piktura)*, Sybella Wilkes, Millbrook Trade, 1995; ISBN: 156294844X
- ◆ *Revista "The New York Times"*, 10 Qershor 2001, "Koha e Ankthit", f 36.

Metodat: Leximi i librave për fëmijë; shikimi dhe bërja e pikturave dhe vizatimeve; konsultimi i fjalorëve; mësimi i përbashkët; ndarja e përbashkët e gjërave të mësuara.

Objektivat: *Studentët do të:*

1. Fëmijët do të inkurajohen të specifikojnë dhe reflektojnë mbi efektet negative që pushkët, armët e vogla dhe të lehta kanë mbi fëmijët. Reflektimet do të bazohen mbi një ekzaminim të serisë së pikturave, vizatimeve dhe punëve artistike të fëmijëve nga rajone të gjithë botës.
2. Studentët do të analizojnë efektet që pushkët, armët e vogla dhe të lehta dhe minat e tokës kanë mbi jetën e fëmijëve në rajone të ndryshme të botës dhe mbi komunitetin e tyre, duke lexuar tekstet e rekomanduara, dhe duke parë pikturat dhe vizatimet e fëmijëve të cilët kanë pasur eksperiencën të drejtpërdrejta me konfliktet e armatosura.
3. Studentët do të identifikojnë dhe përshkruajnë efektet dëmtuese që pushkët, armët e vogla dhe të lehta dhe minat e tokës kanë mbi sigurinë dhe mirëqënjen e fëmijëve duke rradhitur mbiemra dhe/ose ndajfolje që përshkruajnë efektet e armëve të vogla dhe të lehta mbi shoqëritë dhe jetën e fëmijëve në veçanti.

PROCEDURAT

- 1.** Mësuesi prezanton “Një ditë na u desh të vraponim”, apo libra të ngjashëm me figura dhe ilustrime të bëra nga fëmijët. Lexoni një histori për çdo seksion. Pas çdo leximi, bëni pyëtjet e mëposhtme apo të tjera të ngjashme me këto.

 - a)** Për çfarë fliste historia? Kush ishin njerëzit në histori? A kishte ndonjë fëmijë të moshës tuaj, apo në moshën e motrës, vëllait apo shokëve tuaj?
 - b)** Çfarë patë në figurat dhe vizatimet? A vutë re pushkë apo armë të tjera në figurat? Si ju bënë të ndiheshit ato armë?
 - c)** Përse kanë njerëzit armë? Çfarë u bëjnë armët njerëzve?
 - d)** Si mendoni se ndihen fëmijët në këto figura në lidhje me armët? Çfarë u ndodh atyre për shkak të armëve?
 - e)** A mundet njerëzit që po përdorin armët të kishin mënyra të tjera për të arritur atë që ata po përpiqen të bëjnë? Çfarë mënyrash të tjera mund të imagjinoni juve?
- 2.** Filloni një diskutim mbi efektet që pushkët, armët e vogla dhe të lehta dhe minat e tokës kanë pasur mbi fëmijët që kanë ilustruar librat dhe i kërkonte studentëve të ndajnë idetë, eksperiencat, dhe njohuritë e tyre rreth pushkëve, armëve, dhe luftës. I pyesni studentët se si i kanë mësuar ato gjëra që dinë rreth këtyre çështjeve.
- 3.** I kërkonte studentëve që të japin fjalë identifikuese apo përshkruese (mbiemra dhe ndajfolje) për të përshkruar gjendjen dhe ndjenjën e vëzhguar tek ilustrimet e fëmijëve si dhe ndjenjat personale në lidhje me ilustrimet. Nëse studentët nuk janë të familjarizuar me mbiemrat dhe ndajfoljet përpara se të zhvillohet ky mësim, i shpjegoni konceptin dhe teknikën e përshkrimit, duke theksuar se ata kanë përdorur mbiemra dhe ndajfolje për të përshkruar atë që ata kanë parë dhe për të shprehur ndjenjat e tyre.
- 4.** Mbajini përgjigjet e nxënësve në dërrasë apo në tabakë letre, duke bërë një listë të mbiemrave dhe ndajfoljeve që do të përdoren më vonë në përgatitjen e mëvonëshme të Fjalorit të Çarmatimit.

5. Paraqisni dhe përkufizoni termin e “çarmatimit” tek fëmijët dhe merrni reagimet dhe përgjigjet se si çarmatimi mund të kontribuojë në sigurinë dhe mirëqenjen e fëmijëve. Shpjegojini fëmijëve se shumë njerëz nëpër botë po punojnë për çarmatimin si një mënyrë për të krijuar paqen. I thoni atyre për Dekadën e Kombeve të Bashkuara për një Kulturë Paqeje dhe Jodhune për Fëmijët e Botës (Dokument i Kombeve të Bashkuara A/Res/53/25), dhjetë vjet aktivitete për të bërë të mundur që ata dhe të gjithë fëmijët të jenë të sigurtë dhe të jetojnë në paqe. (Për të gjetur më tepër në lidhje me Dekadën e Kombeve të Bashkuara për një Kulturë Paqeje, vizitoni):

http://www.unesco.org/iycp/uk/uk_sum_decade.htm ose

<http://www.un.org/documents/ga/res/53/a53r025.pdf>

6. Paraqisni aktivitetin e krijimit të një Fjalori të Çarmatimit për ti shpjeguar studentëve të tjerë se përse ata mendojnë se çështja është e rëndësishme dhe se përse edhe fëmijët e tjerë gjithashtu duhet të mësojnë rreth saj.
7. Lajmëroni studentët se atyre, në grupe, do t’ju jepet një gërmë apo një grup gërmash nga alfabeti dhe do t’ju kërkohet të identifikojnë një mbiemër apo një ndajfolje që fillon me atë gërmë. Pastaj atyre do t’ju kërkohet të ndërtojnë një fjali duke përdorur mbiemrin apo ndajfoljen për të përshkruar mendimet, ndjenjat, apo eksperiencat e tyre në lidhje me armët e lehta (si psh. pistoletat) dhe/ose në lidhje me faktin se si këto armë kërcënojnë sigurinë e fëmijëve.

Studentët do të përdorin fjalorët dhe enciklopeditë për të gjetur dhe identifikuar mbiemrat dhe ndajfoljet për secilën gërmë të alfabetit që reflektojnë apo përkufizojnë konceptin e çarmatimit që ata do të dëshironin të përfshinin në Fjalorin e Çarmatimit.

Studentët do të rradhisin fjalët alfabetikisht, do të formojnë fjali duke përdorur fjalët dhe duke analizuar idetë e tyre rreth armëve, dhe të ilustrojnë një faqe të Fjalorit të Çarmatimit për ti korresponduar gërmës/gërmave që atyre u janë caktuar.

8. Organizoni studentët në grupe mësimore bashkëpunuese dhe caktoni gërma të ndryshme të alfabetit për secilin grup. Seicili nga grupet do të krijojë një seksion të *Fjalorit të Çarmatimi*:

- ◆ Duke u siguruar që ka fjali dhe ilustrime për çdo gërmë;
- ◆ Duke vënë gërmat, fjalitë dhe ilustrimet në rradhë alfabetike; dhe

- ◆ **Duke bërë një fletë mbuluese dhe një lidhje për pjesën e tyre të fjalorit.**
9. Nëse është e mundur, bëni fotokopje të *Fjalorit të Çarmatimit* në mënyrë që çdo fëmijë të ketë një për vete, për ta lexuar, dhe për ta ndarë me familjen dhe të tjerët.
10. Mbas përfundimit të *Fjalorit të Çarmatimit*, studentët mund të planifikojnë aktivitete për të paraqitur punën e tyre tek studentët e tjerë në shkollë. Disa nga idetë përfshijnë:
- ◆ **Një prezantim publik të të gjitha faqeve;**
 - ◆ **Një asamble të veçantë në të cilën studentët të prezantojnë vizatimet dhe fjalitë e tyre si skeçe humoristike.**
 - ◆ **Vizita nëpër klasat për të shpjeguar problemin e armëve dhe idetë rreth çarmatimit duke prezantuar Fjalorin e tyre të Çarmatimit.**

Kapitulli 4:

Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore

Leksioni 20

Shkallarja

“Shoqëria civile ka një rol qendror për të luajtur në demokratizimin e marrëdhënjeve ndërkombëtare dhe në forcimin e mekanizmave.”

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 50, f. 48

SHKALLARJA

Ndonëse fokusi këtu është mbi edukimin për çarmatimit, aktiviteti pasardhës mësimor mund të adoptohet për të mësuar rreth çfarëdo nga problemet botërore të adresuara nga *Axhenda e Hagës*. Është një mjet për inkurajuar mësimin për veprim të përgjegjshëm social, dhe pjesëmarrjen në fushatat e shoqërisë civile për drejtësi dhe paqe, qëllime edukimore kryesore të edukimit për paqe.

Burimi: Adoptuar nga Fondacioni i Zelandës së Re për Studimet për Paqen, *Extending Peaceful Relationship; A Selection of Activities for Classes and Groups of Secondary School Age {ages 11-14 years}* (Duke Zgjeruar Marrëdhënjet Paqësore; Një Përzgjedhje e Aktiviteteve për Klasat dhe Grupet e Shkollës Tetëvjeçare) {mosha 11-14 vjeç}, 1986, Auckland, f.67.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e larta të shkollës tetëvjeçare, studimet shoqërore, çështjet globale, kulturat e botës, çështjet moderne.

Materialet: Materiale shitesë për studime, materiale mbi çarmatimin, etj., kopje të Axfordës së Hagës, kopje të “Shkallares”.

Metodat: Shpallja e alternativave; dialogu aktiv

Konceptet: Veprimi qytetar, shoqëria civile, bashkëpunimi.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ **Kuptojnë vlerën e përgjegjësisë sociale;**
- ◆ **Përfitojnë aftësi praktike për krijimin dhe propozimin e zgjidhjeve alternative për problemet;**
- ◆ **Pasurojnë njohuritë e tyre mbi mundësitë praktike të çarmatimit.**

PROCEDURAT:

1. Filloni duke paraqitur temën e çarmatimit si rruga më premtuese drejt parandalimit të konflikteve të armatosura dhe luftës. Shpjegoni konceptimin e çarmatimit, duke vendosur theksin në faktin se çarmatimi do të kërkojë veprime më të vendosura dhe institucione më të forta për zgjidhjen pa dhunë të konflikteve. Caktoni Axfordën e Hagës si lexim për në shtëpi.
2. Çfarë mund të bëhet për të lehtësuar/zgjidhur problemet e konflikteve të armatosura dhe luftës (apo problemeve të tjera botërore) që ne po studiojmë tani? Merrni në konsideratë 50 pikat e Axfordës së Hagës për Paqe dhe Drejtësi për Shekullin e 21^{te}. Cila nga këto pika apo propozime mund të çojë drejt çarmatimit të përgjithshëm? Ndiqni hapat e shkallares më poshtë për të konsideruar linjat e ndryshme të veprimit. Për çdo hap, mendoni rreth mënyrave për të arritur propozimet e dhëna, të cilat ju i keni identifikuar ose qëllimet e gjera shoqërore që ju do të dëshironit ti shihnit të realizuara?

◆ **Çfarë mund të bëhet në nivel ndërkombëtar, psh. nga organizata ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara?**

Përgjigjja:

◆ **Çfarë mund të bëhet nga OJQ-të, grupet fetare, politike dhe rinore kombëtare e ndërkombëtare dhe organizata të tjera të cilave ne u përkasim?**

Përgjigjja:

<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga vendi ynë? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga qeveritë tona qendrore dhe lokale? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga komuniteti ynë? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga klubet apo grupet lokale ku ne bëjmë pjesë? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga e gjithë shkolla jonë? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëhet nga klasa jonë në veçanti? Përgjigjja:</p>
<p>◆ Çfarë mund të bëjmë ne si individë? Përgjigjja:</p>

- Rishikoni 50 Rekomandimet e Axhendës së Hagës, duke i dhënë vëmendje të veçantë rekomandimeve të paraqitura në bazën mbi “Çarmatimin dhe Sigurinë Njerëzore”. Shkruani numrin e rekomandimeve në nivelin e shkallares ku ju mendoni se ato mund të jenë efektivisht më të zbatueshme.
- Studentët duhet pastaj të marrin pak kohë dhe të konsiderojnë alternativat e shumta dhe të diskutojnë nivelet e shumta të veprimit, duke përfshirë gjithë propozimet.
- Pasi këto alternativa të jenë diskutuar dhe marrë në konsideratë, planifikoni hapat e veprimeve në të cilët studentët mund të përfshihen në çdo nivel. Shpjegoni se shumë zhvillime për rritjen e paqes dhe drejtësisë në nivelin ndërkombëtar fillojnë me hapa të ndërmarrë nga individët dhe grupet e vogla të qytetarëve; studentët mund të ndërmarrin veprime si qytetarë globalë që mund, si përfundim, të çojnë në ndryshime të mëdhaja mbarëbotërore.

Kapitulli 4:
Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore
Leksioni 20

Gratë, Paqja, dhe Siguria

“Konflikti dhe lufta janë ngjarje me efekte të mëdhaja gjinore...”

Prandaj, gratë dhe burrat përballen dhe influencohen ndryshe nga konflikti dhe dhuna dhe kanë mundësi të ndryshme për sa i takon pushtetit dhe vendimmarrjes. Ekziston nevoja për të... forcuar kapacitetet e grave për të marrë pjesë në iniciativat e paqebërjes dhe për pjesëmarrje të barabartë të grave në zgjidhjen e konflikteve.”

- Axhenda e Hagës, Rekomandimet 34, f. 36

GRATË, PAQJA, DHE SIGURIA

Gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2000, një numër i vogël antarësh të OJQ-ve aktive në problemet e grave në Kombet e Bashkuara zhvilluan dhe ndoqën një strategji për të bërë presion mbi Këshillin e Sigurimit që të mbante një debat të hapur (një sesion mbi një temë të përgjithshme që përbën një kërcënim për sigurinë dhe paqen, dhe jo mbi një konflikt apo krizë të veçantë e specifike) mbi rolin e gruas në formimin e politikave të paqes dhe sigurisë, zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve, dhe sigurinë mbarëbotërore. Sesioni u mbajt në Tetor 2000. Kjo njësi është e bazuar në idetë kryesore të nxjerra nga rezoluta e adoptuar nga Këshilli i Sigurimit në mbarim të Sesionit Special. Këto ekstrakte paraqiten në faqet e mëposhtme si materiale për shpërndarje. (Kopje të tekstit të plotë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit janë të gjetshme nëpërmjet Thirrjes së Hagës për Paqe dhe në Internet në: www.peacewomen.org/un/sc/1325.html)

Burimi: Kjo njësi është krijuar nga autorët e *Mësimin për Ndalimin e Luftës*.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e larta të shkollës tetëvjeçare, studimet shoqërore, problemet botërore/çështjet globale, të drejtat e njeriut, studimet gjinore.

Materialet: Materialet për shpërndarje nga përzgjedhja e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (në faqet që vijojnë), ose të tërë dokumentin (i gjetshëm në internet në faqen www.peacewomen.org).

Metodat: Kërkimi dhe prezantimi i raporteve; analizimi kritik dhe diskutimet; luajtja e roleve; propozimi i alternativave.

Konceptet: Gjinia, siguria, paqja, diplomacia ndërkombëtare, shoqëria civile.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ Familjarizohen me funksionimin e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë procedurat dhe dokumentimin;
- ◆ Mësojnë rreth strategjive të grave për paqe dhe ndërtimin e paqes;

- ◆ **Analizojnë lidhjen midis përfaqësimeve të gjinisë dhe konfliktit në media;**
- ◆ **Demonstrojnë të kuptuarin e mënyrave të ndryshme që konflikti dhe lufta ndikojnë tek burrat dhe gratë.**

PROCEDURAT:

AKTIVITETI 1

1. Jepini përzgjedhjet si lexime që duhen bërë jashtë klasës.
2. Në sesionin pasardhës të klasës lexoni përzgjedhjet (ose bëni që studentët të lexojnë me zë të lartë nga një paragraf secili).
3. Pasi një paragraf të jetë lexuar, dikutojeni atë, duke bërë pyetje të tipit:
 - a. Çfarë problemesh ose pengesash për paqen dhe pjesëmarrjen e grave në zgjidhjen e konflikteve dhe/ose bërjen e politikave të sigurisë janë më të mundshmet që kanë insipruar këtë paragraf?
 - b. Çfarë linjash të veçanta veprimi duhet që të ndjekin Kombet e Bashkuara për të kapërcyer problemet dhe pengesat dhe për të arritur qëllimin e përqafuar në paragraf?
 - c. Çfarë veprimesh mund të ndërmerren OJQ-të (Organizatata Jo Qeveritare) dhe qytetarët për të siguruar zbatimin e qëllimeve të shprehura në paragraf?
 - d. A ka veprime që mund të ndërmerren nga studentët?

AKTIVITETI 2

1. Paraqisni një listë të Instrumentave Ligjorë Ndërkombëtarë të rëndësishëm në lidhje me Rezolutën. Për shembull:
 - ◆ **Konventa e Gjenevës e 1949 dhe Protokollin i 1949**
 - ◆ **Konventa mbi Refugjatët e 1951 dhe Protokollin i 1967**
 - ◆ **Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993)**
 - ◆ **Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (1979) dhe Protokollin Opcional i 1999.**

Shënim: Për këto dhe të tjerë instrumente ligjorë të rëndësishëm, vizitoni www.un.org/rights/

2. Formoni grupe kërkimore. I jepni seicilit grup një Konventë për ta lexuar, studiuar, dhe diskutuar dhe më vonë për të raportuar përpara gjithë klasës përgjigjet e tyre në lidhje me pyetjet në vazhdim për ti mundësuar ata për të analizuar rëndësinë e instrumentit për problemet dhe qëllimet e reflektuara në Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
 - a. Kush janë qëllimet e Konventës?
 - b. Cilat probleme janë më të mundëshmet që mund të kenë çuar në përgatitjen dhe miratimin e konventës?
 - c. Për cilat qëllime dhe rekomandime të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mund të aplikohet kjo konventë?
 - d. Cilat nene të konventës do të ishin më të rëndësishmet?
 - e. Kush duhet të jetë i ndërgjegjshëm për ekzistencën e kësaj konventë që të ndihmohej arritja e qëllimeve të Rezolutës 1325?
 - f. Çfarë duhet të dinë qytetarët e thjeshtë rreth Konventës?

AKTIVITETI 3

1. Caktoni një projekt për lajmet në media ku çdo student duhet të identifikojë një zhvillim të një lajmi në lidhje me konfliktet e armatosura.
2. Shikoni se si raportohet në mediat e ndryshme. Vlerësoni dimensionet e mundëshme gjinore të konfliktit.
 - a. Si ndikon në mënyrë të ndryshme tek burrat dhe tek gratë?
 - b. A kanë gratë nevoja të veçanta si pasojë e konfliktit? Kush janë këto nevoja?
 - c. A po plotësohen këto nevoja në mënyrë të përshtatshme? Kush po përpiqet ti plotësojë ato? A ka institucione të tjera që duhet të përfshihen?
3. A janë të prezantuara në media aspektet gjinore të konfliktit? A është prezantimi i përshtatshëm për problemet në fjalë?
4. Përgatitni një letër drejtuar disa nga mediave që ju keni vëzhguar duke dhënë opinionin tuaj në lidhje me mbulimin gjinor të lajmeve si dhe sygjerimet tuaja për ndryshimin apo përmirësimin e tij.
5. Lexojeni letrën përpara klasës. Duke përdorur argumenta të mirë arsyetuara, përpiquni të bindni shokët tuaj të klasës ta nënshkruajnë letrën bashkë me ju dhe dërgojani atë mediave.

AKTIVITETI 4

1. Caktoni lexime mbi aktivitet e paqes të ndërmarra nga gratë dhe diskutoni raportet në klasë. (Materialet janë të gjetshëm nga **Women's International Tribune Center**, *Qendra e Tribunës Ndërkombëtare të Grave*; 777 UN Plaza, NYC 10017; www.peacewomen.org, një projekt i Lidhjes Ndërkombëtare të Grave për Liri dhe Paqe; UNIFEM; Kombet e Bashkuara; UNESCO, Paris; dhe Kujdesi Ndërkombëtar, Londër).

2. Hidhni temat e mëposhtme në diskutim:
 - a. Perspektivat dhe motivimet individuale
 - b. Stilet e aksioneve të paqes që gratë ndjekin dhe përse këto lloje veprimi mund të jenë zgjedhur?
 - c. Pengesa dhe avantazhe të veçanta të efektivitetit të grave në ndjekje të paqes.

MATERIAL PËR SHPËRNDARJE

I nxjerrë nga:

REZOLUTA E KOMBEVE TË BASHKUARA (S/RES/1325)

*E miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (Preambula është lënë mënjanë)
Këshilli i Sigurimit*

1. I kërkon Shteteve Antarë të sigurojnë përfaqsimin e rritur të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet kombëtare, rajonale, dhe ndërkombëtare për parandalimin, manaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve;
2. Inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm të zbatojë planin e tij strategjik të veprimit (A/49/587) që thërret për një rritje të pjesëmarrjes së grave në nivelet e vendimmarrjes për zgjidhjen e konflikteve dhe proceset e paqes;
3. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të caktojë më tepër gra si përfaqësues të veçantë dhe si të dërguara...;
4. I kërkon më tutje Sekretarit të Përgjithshëm të synojë zgjerimin e rolit dhe kontributit të grave në operacionet e Kombeve të Bashkuara të bazuara në terren, dhe në veçanti midis vëzhguesve ushtarak, policisë civile, personelit të të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare;
5. Shpreh gatishmërinë e tij për të trupëzuar një perspektivë gjinore në operacionet e paqeruajtjes, dhe i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të sigurojë që, atëherë kur është e mundur, operacionet në terren të përfshijnë një përbërës gjinor;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që tu japë shteteve antare udhëzime trajnuese dhe materiale mbi mbrojtjen, të drejtat, dhe mbrojtjen e veçantë të grave...;
7. I kërkon Shteteve Antarë që të rrisin vullnetarisht mbështetjen e tyre financiare, teknike, dhe logjistike për përpjekjet trajnuese mbi ndjeshmërinë gjinore...;
8. I tërheq vemendjen të gjithë palëve të përfshira në negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve për paqe, që të adoptojnë një perspektivë gjinore, duke përfshirë, *inter alia* (midis të tjerave):
 - a. Nevojat e veçanta të grave dhe vajzave gjatë riatdhesimit dhe rivendosjes si dhe për rehabilitimin, reintegrimin, si dhe rikonstruktimin pas konfliktit;
 - b. Masa që mbështesin proceset e grave lokale për zgjidhjen e konflikteve, dhe që përfshijnë gratë në të gjitha mekanizmat zbatues të marrëveshjeve të paqes;
 - c. Masa që sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me Kushtetutën, sistemet e zgjedhjeve, policinë, si dhe gjyqësorin;
9. I bën thirrje të gjitha palëve në konflikte të armatosura që të respektojnë plotësisht ligjin ndërkombëtar të aplikueshëm mbi të drejtat dhe mbrojtjen e grave dhe të vajzave...;
10. I bën thirrje të gjitha palëve në konflikte të armatosura që të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna e bazuar në ndryshimin gjinor, veçanërisht përdhunimi dhe forma të tjera të abuzimit seksual, si dhe të gjitha format e tjera të dhunës që shfaqen në situatat e konflikteve të armatosura;
11. Thekson përgjegjësinë e të gjitha Shteteve për ti dhënë fund padënueshmërisë dhe për të gjykuar ata që janë të përgjegjshëm për krimet e genocidit, krimet kundër njerëzimit, si dhe krimet e luftës duke përfshirë ato që kanë lidhje me dhunën seksuale dhe dhunime të tjera kundrejt grave dhe vajzave;
12. I bën thirrje të gjitha palëve në konflikte të armatosura që të respektojnë karakterin civil dhe humanitar të kampeve dhe vendqëndrimeve të refugjatëve, dhe që të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave...;
13. Inkurajon të gjithë ata që janë të përfshirë në planifikimin e çarmatimit, çmobilizimit dhe reintegrimit që të konsiderojnë nevojat e ndryshme të femrave dhe burrave ish-ushtarakë dhe të marrin në konsideratë nevojat e atyre që varen prej tyre.
14. Riafirmon gatishmërinë e tij, kurdo që masa ndërmerren sipas Artikullit 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që të marrë në konsideratë impaktin potencial të këtyre masave mbi popullsitë civile, duke pasur ndër mend nevojat e veçanta të grave dhe vajzave, në mënyrë që të ndërmerren dhe zbatohen përjashtimet e duhura humanitare.

15. Shpreh gatishmërinë e tij për të siguruar që misionet e Këshillit të Sigurimit të marrin parasysh konsideratat gjinore dhe të drejtat e grave, duke përfshirë konsultime me organizatat dhe grupimet e grave kombëtare dhe ndërkombëtare...;
16. Fton Sekretarin e Përgjithshëm që të ndërmarrë një studim mbi impaktin e konflikteve të armatosura mbi gratë dhe vajzat, mbi rolin e grave në ndërtimin e paqes, si dhe dimensionet gjinore të proceseve të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve, dhe më tutje e fton atë të paraqes një raport përpara Këshillit të Sigurimit mbi rezultatet e këtij studimi dhe që tua paraqes këtë studim të gjithë Shteteve Antare të Kombeve të Bashkuara;
17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, kur të jetë e mundur, që të përfshijë në raportimin që bën përpara Këshillit të Sigurimit progreset e bëra mbi zbatimin e politikave gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse si dhe për të gjithë aspektet që lidhen me gratë dhe vajzat;
18. Vendos që të qëndrojë i lidhur aktivisht me këtë çështje.

Kapitulli 4:

Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore

Leksioni 22

Kundërshtimi i Ndërgjegjshëm ndaj Luftës

“Ne jemi thellësisht të inkurajuar nga fakti që shoqëria civile si dhe qeveritë përparimtare po zgjedhin shtigjet “e fuqisë së butë”, duke përdorur negociimin, krijimin e koalicioneve si dhe metodat e reja të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duke hequr dorë nga diktatet e “fuqisë së ashpër” të fuqive të mëdhaja, ushtrive dhe konglomerateve ekonomike.”

- *Axhenda e Hagës, Temat , f. 5*

KUNDËRSHTIMI I NDËRGJEGJSHËM NDAJ LUFTËS

Shumë të rinj, të zgjedhshëm për shërbim ushtarak, kanë përkushtuar vetveten tek vlerat që gjenden tek përqsja e “fuqisë së butë”. Mbi baza etike dhe/ose fetare, shumë kanë refuzuar shërbimin ushtarak si një qëndrim moral dhe akt rezistence ndaj luftës. Në mënyrë të ngjashme, qytetarë të të gjitha moshave kanë refuzuar të paguajnë taksat që mbështesin mbajtjen dhe përdorimin e një ushtrie të madhe dhe të kushtueshme. (Njësia mësimore në vazhdim është pjesë e një burimi programor më të madh e më të plotë mbi kundërshtimin e ndërgjegjshëm që po përgatitet nga Rosa Packard.)

Burimi: Kjo njësi është adoptuar nga një punim i Rosa Packard, Përfaqësuese e një OJQje, Conscience and Peace Tax International (SHBA). Njësia paraqet konceptet e paqes dhe drejtësisë në lidhje me të drejtat e kundërshtuesve të ndërgjegjshëm.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e para të shkollës së mesme, histori, qytetari, studimet shoqërore, problemet botërore, studimet e fesë, filozofi.

Materialet: Materiale të shkruajtura, dërrasë e zezë ose materiale për shkrim, pasja e një telefoni si dhe një kompiuteri/interneti për kërkime, printime të burimeve të cituara në bibliografi.

Metodat: Tregimi i historive; reflektimi personal mbi pyetjet; stuhi të ideve për mbledhjen e pyetjeve dhe burimeve për kërkim; studim i pamvarur; dëgjim aktiv në çift; raportim; diskutim në klasë.

Konceptet: Paqja, drejtësia, jodhuna, rezistenca, kultura e paqes, kundërshtimi i ndërgjegjshëm.

Objektivat: *Studentët do të fitojnë:*

- ◆ Një ndërgjegjësim për diskriminimin shumë të përhapur ndaj atyre të cilëve besimi fetar ose besimet morale nuk ua lejon që të marrin pjesë në luftë dhe që i rezistojnë presionit për të vepruar kundër besimit të tyre;
- ◆ Kuptimin e diferencave midis një kulture lufte që synon të ndalojë, kërcënojë, dhe të vrasë armikun dhe një kulture paqeje që synon të kujdeset dhe të mbrojë si të shtypurin ashtu edhe shtypësin ndërsa transformon dhe parandalon shtypjen në mënyrë paqësore;
- ◆ Qartësimin e besimeve personale dhe respektin për besimet e të tjerëve;

PROCEDURAT:

I informoni studentët se Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën 1988/77 të 22 Prillit 1998, tërheq vëmendjen mbi të drejtën e gjithëkujt për të ushtruar kundërshtimin e ndërgjegjshëm ndaj shërbimit ushtarak si një shprehje e legjitimuar e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, dhe besimit fetar, ashtu siç parashtrohet në Nenin 18 të *Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut* dhe Nenit 18 të *Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Civile*, si dhe një shprehje nga shoqërisë civile. *Deklarata e dhe Axhenda për Veprim e Forumit të Mijëvjeçarit NE NJERËZIT* (22-26 Maj 2000) thotë, “Në kontekstin e mosqenjes bashkëpunor në vrasje, neve bëjmë thirrje për njohje të plotë ligjore të së drejtës për kundërshtim të ndërgjegjshëm” (f.17).

PJESA I: Filloni aktivitetin me një prezantim nga mësuesi. (*Përafërsisht 20 minuta*)

1. Referojuni dhe tregoni thëniet e mësipërme rreth kundërshtimit të ndërgjegjshëm nga dokumentat e Kombeve të Bashkuara.

2. Shkurtimeisht shpjegoni pozicionin ligjor të kundërshtuesve të ndërgjegjshëm në shtetin që është zgjedhur studiohet, ose në vendin ku njëzia po mësohet.
3. Lexojini me zë të lartë klasës historinë e një kundërshtuesi të ndërgjegjshëm që refuzonte të merrte pjesë në luftë në shtetin që po studiohet, ose shfaqni një videokasetë që ka lidhje me këtë temë ose ftoni një kundërshtues të ndërgjegjshëm që të flasë përpara klasës. (Materiale të vlefshme mund të gjenden nga Lidhja e Pajtitimit (*Fellowship of Reconciliation*) Pax Christi si dhe Rezistuesit Ndërkombëtar të Luftës. Shikoni listën e burimeve të organizatave në Librin 3.)

PJESA II: Aktivitetet në Klasë: Reflektimi Personal dhe Plani Studimor (*përafërsisht 30 minuta deri në një orë*)

1. I kërkoni studentëve të kalojnë dhjetë minuta duke reflektuar dhe duke shkruajtur mbi mendimit dhe besimit të tyre aktual rreth pjesëmarrjes në luftë, rreth eksperiencave që kanë ndikuar tek ta, dhe rreth rasteve kur ata kanë vepruar në baze të besimit të tyre. Mos kërkoni një përkufizim përfundimtar, ose mos i kërkoni që t’ju japin juve apo ta ndajnë atë me klasën. Qëllimi është që ata të bëhen më të ndërgjegjshëm rreth asaj që ata dinë dhe asaj që nuk dinë, si dhe rreth asaj për të cilën ata janë të qartë apo të paqartë.
2. Në fund të dhjetë minutave, pyesni nxënësit nëse kanë pyetje apo çështje për studim të mëtejshëm. Mësuesi duhet ti marrë ato pa i gjykuar apo diskutuar dhe ti shkruaj ato të gjitha në një tabak letrë apo në dërrasë të zezë. Nëse ka ndonjë të ftuar me eksperiencë të posaçme, ata mund të jenë të aftë që tu përgjigjen pyetjen.

PJESA III: Detyra në grup për të ndihmuar trajtimin e pyetjeve dhe çështjeve.

1. Diskutoni se si mund të ndihmohet një shok që gjendet në vështirësi në lidhje me vendimin për pjesëmarrje në ushtri. Ata mund të mos jenë të qartë rreth të drejtave të tyre apo të paqartë rreth disa aspekteve të gjërave në të cilat ata besojnë, ose mund të mos jenë të informuar në lidhje me pasojat e vendimeve të ndryshme ose të mos jenë në dijeni të burimeve të mbështetjes. Së bashku, rrathisni pyetjet që kanë nevojë për kërkim.
2. Caktoni detyrat kërkimore.
3. Kontaktoni grupe suportu apo këshillimi për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm në vendin që po studioni. I pyesni atyre pyetje të ndryshme që mund t’ju ndihmojnë juve që të ndihmoni shokun

tuaj. Juve mund tu thoni atyre që kjo përpjekje është pjesë e kërkimit tuaj për edukimin për paqe. (Ndhmë mund të merrni nga organizatat e paraqitura në Pjesën I, hapi 3.)

4. Eksploroni burimet që ata ju sygjerojnë – këto mund të jenë burime ligjore, literaturë e legjislacioneve qeveritare nga grupet kombëtare, ose këshillues lokalë që japin informacion dhe mbështetje.
5. Përgatisni një raport të grupit të bazuar në kërkimin që keni bërë.

PJESA 1V: Detyra individuale për të ndihmuar trajtimin e pyetjeve dhe çështjeve.

1. Jepini detyrat e mëposhtme secilit nxënës: Tregoni historinë e një kundërshtuesi të ndërgjegjshëm të shërbimit ushtarak (KNSHU) apo të një kundërshtuesi të ndërgjegjshëm të pagimit të taksave ushtarake (KNTU). Nëse njihni ndokënd që ka një eksperiencë të tillë, merrni në konsideratë një intervistë me të. Përndryshe shikoni histori të kundërshtuesve të ndërgjegjshëm individual në burimet që jepen në bibliografi. Kush është besimi i tyre rreth pjesëmarrjes në luftë? Si i çoi ky besim tek veprimi i tyre? A i bëri të vuante qeveria e tyre apo njerëz të tjerë për këtë besim? Çfarë pune apo shërbimi zgjodhën ata si një alternative ndaj luftës?

PJESA V: Diskutim në klasë mbi analizimin e rezultateve

1. Merrni në konsideratë idenë që ti ndani studentët në çifte dhe që ata të shkëmbejnë raportet me njëri tjetrin, ti japin njëri tjetrit editorialet, kërkimet, si dhe sygjerime thelbësore për përmirësim.
2. Merrni në konsideratë idenë që ti kërkoni studentët të prezantojnë raportet e tyre përpara klasës.
3. Merrni në konsideratë idenë që të mbani një dialog grupi në të cilin studentët mund të flasin me rradhë (ose të mos flasin nëse nuk dëshirojnë) rreth çështjeve që kanë të bëjnë me eksperiencat e tyre individuale. Ndërsa mësuesi lehtëson këtë dialog, ai i shpjegon studentëve se atyre nuk u kërkohet që të debatojnë, vënë në diskutim, apo të diskutojnë mbi eksperiencat e të tjerëve, por vetëm të flasin për veten e tyre kur u vjen rradha.
4. Merrni në konsideratë veprime individuale apo në grup që mund të dalin prej studimit, si për shembull:

- ◆ **Shkrimi i letrave për të burgosurit e ndërgjegjes, ashtu siç bëhet prej Amnesty International;**
- ◆ **Shkrimi i letrave për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm të burgosur apo të “dënuar” në ndonjë mënyrë tjetër për shkak të refuzimit të tyre për të mos vrarë;**
- ◆ **Shkrimi i letrave për të sygjeruar përmirësim të legjislacionit;**

- ◆ **Formimi i degëve të mbështetjes apo i grupeve të suportimit;**
- ◆ **Dizenjimi i posterave, broshurave informative, etj. për edukim publik;**
- ◆ **Mbajtja e një forumi për gjithë shkollën ku të diskutohen çështjet e kundërshtimit të ndërgjegjshëm si dhe çështje të tjera publike që ngrenë pyetje për ndërgjegjen.**

Bibliografia e Zgjedhur

Peter Brock, *The Quaker Peace Testimony: 1660 to 1914*, (Dëshmia e Paqes së Quaker): nga 1660 deri në 1914, York, Angli, Session Book Trust, 1990.

Linda Coffin, *Handbook on Military Taxes and Conscience*, (Doracak mbi Taksat Ushtarake dhe Ndërgjegjen), sponsorizuar nga Komiteti mbi Konsultimin i Miqve të Botës, Filadelfia: Komiteti i Miqve mbi Shqetësimet për Taksat e Luftës, 1998.

Conscientious Objection to Military Service and Military Taxation in Japan, (Kundërshtimi i Ndërgjegjshëm ndaj Shërbimit Ushtarak dhe Taksimit Ushtarak në Japoni). Material Burimor për Prezantimet e Mësuesve.

Eileen Eagen, *Peace Be With You: Justified Warfare or the way of Nonviolence*, (Paqja Qoftë Me Ju: Lufta e Justifikuar apo Ruga e Jodhunës), Botimet Orbis, 1999.

Bart Horeman dhe M. Stolwijk, *Refusing to Bear Arms: A World Survey of Conscription and Conscientious Objection to Military Service*, (Refuzimi i Mbajtjes së Armëve: Një Sondazh Botëror mbi Mobilizimin Ushtarak dhe Kundërshtimin e Ndërgjegjshëm ndaj Shërbimit Ushtarak), War Resisters International, Shtator, 1998.

Robert Seeley, *Choosing Peace, A Handbook on War, Peace, and Young Conscience*, (Zgjedhja e Paqes, Një Doracak mbi Luftën, Paqen, dhe Ndërgjegjen e të Rinjve), Komiteti Qendror për Kundërshtuesit e Ndërgjegjshëm, Filadelfia, SHBA, 1994.

4/2000/55, 17 Dhjetor 1999, *Civil and Political Rights, Including the Question of Conscientious Objection to Military Service Report of the Secretary General* (Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Duke Përfshirë Çështjen e Kundërshtimit të Ndërgjegjshëm për Shërbimin Ushtarak) i dhënë në vijim të rezolutës 1998/77 të Komisionit. Dokumenti i Kombeve të Bashkuara E/CN.

Pika lidhje, duke përfshirë edhe bibliografitë jepen në faqen internet të Organizatës Ndërkombëtare Ndërgjegjja dhe Taksa e Paqes www.cpti.ws

Kapitulli 4: Çarmatimi dhe Siguria Njerëzore Leksioni 23

Dhuna e Globalizimit: Një Problem i Sigurisë Njerëzore

“Globalizimi ekonomik ka lënë mënjanë seksione shumë të mëdhaja të popullatës botërore, duke zmadhuar edhe me shumë hendekun midis të pasurve dhe të varfërve.”

- *Axhenda e Hagës, Rekomandimet 2, f. 14*

DHUNA E GLOBALIZIMIT: NJË PROBLEM I SIGURISË NJERËZORE

Vizioni i një kulture paqeje bazohet në pjesën më të madhe në arritjen e sigurisë së pastër njerëzore. Feministet dhe eko-feministet (feministet ekologjike) si Vandana Shiva e shohin sigurinë njerëzore si një kusht në të cilin planeti i shëndetshëm Tokë mund të përmbush nevojat për një jetesë dinjitoze për njerëzimin i cili e shikon vetveten si një përbërës i Tokës së gjallë për të cilën ai ka përgjegjësi. Nga një perspektivë e tillë, dhuna, apo dëmtimi i panevojshëm, merr forma të ndryshme, ndër të cilat forca e armëve dhe luftimet vdekjeprurëse janë vetëm një pjesë. Në leximin thelbësor të kësaj njësie mësimore, Vandana Shiva jep shembuj jetësore të dëmtimit të panevojshëm, në formën e dhunës strukturale, që globalizimi po i shkakton si mbi njerëzimin ashtu edhe mbi planetin, duke vendosur një pengesë të madhe për arritjen e sigurisë njerëzore.

Burimi: Kjo njësi mësimore është krijuar nga autorët duke u bazuar mbi tekstin “Dhuna e Globalizimit”, një artikull i cili është botuar në faqen internet <http://www.thehindu.com/> dhe u publikua fillimisht në Indi në *The Hindu*, 25 Mars 2001. Kjo pjesë është përfshirë me lejen e autores.

Niveli Klasor dhe Lënda: Klasat e para të shkollës së mesme, histori, qytetari, studimet shoqërore, problemet botërore, të drejtat e njeriut, studime gjinore.

Materialët: Kopje të materialit për shpërndarje nga “Dhuna e Globalizimit” që gjendet në fund të kësaj njësie; një glob ose një hartë bote; blloqe të vegjël për shënime; kasete; pjesë gazetash me lajme të sjella nga studentët.

Metodat: Diskutime në grupe të vegjël dhe diskutime të përgjithshme në klasë, raporte mbi leximin e gazetave dhe mbi kërkimet e bëra.

Konceptet: Dhuna (duke përfshirë dhe dhunën strukturale); globalizimi dhe varfëria; siguria ekonomike; dhe siguria ekologjike, kombëtare, globale dhe njerëzore.

Objektivat: *Studentët do të:*

- ◆ **Rrisin ndërgjegjësimin dhe kuptimin e natyrës së dhunës dhe format e shumta të saj;**
- ◆ **Zhvillojnë kuptimin e natyrës së institucioneve dhe politikave që përbëjnë globalizimin;**

- ◆ **Demonstrojnë familiaritet me gjeografinë botërore dhe implikimet e konflikteve gjeopolitike;**

PROCEDURAT:

1. Shpërndani dhe caktoni si detyrë materialet për shpërndarje nga dëshmia e Vandana Shivas në Gjyqin Botëror të Grave në Kejptaun (Capetown), Afrika e Jugut, 8 Mars 2001. I instruktioni studentët që ti lexojnë materialet si detyrë shtëpie.

Aktivite mësimore të bazuara në tekst:

2. Vendosni këtë pyetje përpara gjithë klasës: Çfarë është dhuna dhe ku gjendet ajo?
3. Organizoni grupe diskutimi më të vogla në të cilat studentët do të diskutojnë shembujt e cituar nga Vandana Shiva. I kërkoni secilit grup që të prezantojë përkufizimin e vet për dhunën dhe drejtoni klasën që të kuptoni se shumica e formave të dhunës është dëmtim dhe vuajtje që nuk duhet të ndodhë. Ajo rezulton si rrjedhojë e vendimeve të marra nga individët, politikatat e bëra nga qeveritë dhe shoqëritë e padrejta. Disa mësues mund të duan të prezantojnë dhe diskutojnë konceptin e dhunës strukturale.
4. Në grupe të vegjël, jepni si detyrë leximin e gazetave dhe revistave të lajmeve për të gjetur histori që demonstrojnë format e dhunës që Shiva përshkruan. Kërkoni vullnetarë që të përmbledhin historitë e tyre dhe të tregojnë se në ç'pjesë të botës ka ndodhur seicila. Jepini një emër kësaj forme të dhunës, dhe shkruajeni një copë të vogël letre duke e venë si shtesë shpjeguese në glob ose në një hartë bote. Vazhdojeni këtë proces deri sa të jetë e dukshme nga sasia e letrave se ekzistojnë shumë forma dhune, dhe se asnjë rajon në botë është pa dhunë.
5. Mblidhuni së bashku si klasë për të diskutuar: Çfarë është Globalizimi dhe se si ka ardhur ai deri në fazat e sotme?
6. Organizoni edhe një herë grupet, kësaj here me studentë të tjerë në çdo grup. I kërkoni secilit grup që të diskutojnë pyetjet e mëposhtme si një hulumtim mbi globalizimin?
 - ◆ **Çfarë përshkruan Shiva si “transferimi i pasurisë”?**
 - ◆ **Çfarë është pasuria së cilës ajo i referohet?**
 - ◆ **Cili është roli i korporatave?**
7. Seicili grup duhet të raportojë përgjigjet e veta përpara klasës si një bazë për diskutimin se si burimet dhe materialet e para lëvizin nga zonat e varfëruara të botës tek ato më të pasura, se si kjo rrjedhë të mirash e materialesh është e përfshirë në borxhet që marrin vendet më të varfëra, se si kreditë nga institucionet globale financiare rrisin varfërinë në botë.

8. Më pas, organizoni një debat mbi temën e faljes së borxheve, duke dhënë instruksione që argumentat të jepen mbi baza si ekonomike ashtu edhe etike, p.sh. cila do të ishte kostoja ekonomike, kush do ti paguante ato, dhe kush do të ishte rezultati i drejtë. Mësuesi mund të dojë të përgatisë paketa informacioni për përgatitjen e debatit apo ti kërkojë studentëve që të ndërmarrin kërkime mbi temën e krizës së borxheve.

Në diskutimin/debat, vendosni pyetjet e mëposhtëme qendrore:

- ◆ **Çfarë janë siguria kombëtare dhe globale; çfarë i bën kombet dhe botën të sigurtë?**
 - ◆ **Si ndikon globalizimi tek siguria njerëzore?**
9. I organizoni grupet, duke e ndryshuar edhe një herë përbërjen e tyre. Vendosni pyetjet e mëposhtme për tu eksploruar nga grupet.

- ◆ **Çfarë është siguria kombëtare?**
- ◆ **Si përpiqen ta sigurojnë shtetet sigurinë e tyre kombëtare?**
- ◆ **Cila është lidhja midis formave të dhunës të përshkruara nga Shiva dhe dhunës së armatosur të luftës?**
- ◆ **Çfarë mund të përfshihet në idenë e sigurisë ekonomike dhe si lidhet ajo me sigurinë njerëzore?**
- ◆ **Sa i rëndësishëm është ambjenti për sigurinë njerëzore?**
- ◆ **Çfarë mendoni se duhet të përfshihet në konceptin (idenë) e sigurisë njerëzore?**

10. Grupet raportojnë përpara klasës.

Kur grupet të raportojnë përpara klasës, i drejtoni diskutimet që të hedhin dritë mbi ndërlidhjet midis formave të ndryshme të dhunës. Pyesni nëse studentët besojnë se lufta mund të ndalohet nëse format e tjera të dhunës nuk ulen në mënyrë domethënëse. Kur të diskutoni sigurinë njerëzore vendosni theksin mbi natyrën shumëdimensionale të konceptit dhe krahasojeni atë me sigurinë kombëtare, të mbrojtur nëpërmjet mënyrash ushtarake.

Material për shpërndarje

Dhuna e Globalizimit

Nga Vandana Shiva

Përmbledhje: “Mbrotjtje” është bërë një fjalë e ndyrë në erën e tregjeve të lira dhe globalizimit. Por, thotë Vandana Shiva, përhapja e liberalizimit vetëm sa ka çuar drejt formave të reja të dhunës ndaj njerëzimit. Pjesë nga dëshmia e saj përpara Gjyqit Botëror të Grave, në Afrikën e Jugut, në 8 Mars 2001, e kuotuar nga The Hindu, e 25 Marsit 2001, Indi.

Ne menduam se i lamë skllavërinë, holokaustin, dhe aparteidin prapa nesh, se njerëzimi nuk do të lejonte më kurrë çnjerëzimin dhe sistemet e dhunshme që ti jepnin formën rregullave sipas të cilave ne lindim e vdesim. Dhe prapë globalizimi po e ngre përsëri skllavërinë e re, holokaustin e ri, aparteidin e ri. Është një luftë kundër natyrës, grave, fëmijëve, dhe të varfërve. Një luftë që po transformon çdo komunitet dhe shtëpi në një zonë lufte. Është një luftë e monokulturave (kulturave të vetme) kundër diversitetit, e të madhit kundër të voglit, e teknologjive të luftës kundër natyrës. Teknologjitë e luftës po bëhen baza e prodhimit në periudha paqesje. Agjenti Portokalli, që u hodh mbi Vietnam, tani po spërkatet mbi fermat tona si herbicid, bashkë me Round-Up dhe helme të tjera.

Bimët dhe kafshët po krijohen e modifikohen gjenetikisht, duke i bërë kështu fushat tona qendra të luftrave biologjike. Dhe inteligjencë e sëmurë po përdoret për të përfunduar ciklet jetësore të ripërtëritjes duke krijuar fara “Vrasëse” që janë sterile. Me rritjen e dhunës, presioni mbi shoqëritë, ekosistemet, dhe qenjet e gjalla po arrin nivele shkatërrimtare. Ne jemi të rrethuar nga procese të shkatërrimit ekologjik dhe shoqëror.

Ju jeni dëshmitarë të ngjarjeve të kohëve tona që janë tani lajme të faqeve të para. Lopë në Europë që i janë nënshtruar encelopatisë bovine spongiforme BSE (sëmundja e lopës së çmendur), miliona kafshë që digjen me shpërndarjen e sëmundjes së këmbëve dhe gojës që vjen nga tregtia e shumëfishuar, fermerët në Indi që kryejnë vetëvrasje me mijra, Talibanët që shkatërrojnë trashgimninë e tyre duke vandalizuar Budat e Bamiyan-it, një djalë 15 vjeçar Charles Andrew Williams që qëllon shokët e tij të klasës në një shkollë të mesme të Kalifornisë, spastrimi etnik.

Të gjitha këto luftra të kohës së paqes, që ngjajnë në jetën tonë të përditshme dhe shprehjet e fundi të dhunës në një sistem që ka vendosur përfitimin përmbi jetën, tregëtinë përmbi drejtësinë, etikën dhe ekologjinë si teknologji të dhunshme. Lopët janë barngrënëse, ato nuk janë bërë që të hanë kufomat e tyre. Por, në një sistem industrial të bujqësisë së fabrikave të globalizuar nën rregullat e agrikulturës sipas tregëtisë së lirë, ishte “eficiente” që të grihej mishi i deleve dhe lopëve të

infektuara dhe të kthehej në ushqim për gjedhë. Kjo ka përhapur BSE midis gjedhëve - një sëmundje që mund të transmetohet tek njerëzit.

Fëmijët duhet të luajnë me shokët e tyre. Shkollat nuk janë menduar që të jenë zona lufte. Por një kulturë e armëve dhe dhunës, e kombinuar me një kulturë që është fokusuar kaq shumë mbi tregtinë dhe rritjen ekonomike dhe mbledhjen e materialeve, i ka lënë gjeneratat e ardhshme të çrrënjosura dhe të shpërndara, të friksuara dhe të dhunshme.

Fëmijeve tanë u është vjedhur fëmijëria. Në Irak, 12 fëmijë vdesin çdo ditë për shkak të embargos së tregtisë. Në rajone të tjera, fëmijët shtyhen në prostitucion apo luftra si opioni i tyre i vetëm për mbijetesë kur shoqëritë shkatërrohen. Nëpër Botën e Tretë, uria dhe kequshqimi janë rritur si rezultat i rregullimeve strukturale dhe politikave të liberalizimit të tregtisë.

Gjatë viteve 1979/1981 dhe 1992-1993, marrja e kalorive u ul me tre për qind në Meksikë, 4.1 për qind në Argjentinë, 10.9 për qind në Kenia, 10.0 për qind në Tanzani, 9.9 për qind në Etiopi. Në Indi konsumimi i drithërave për person u ul me 12.2 për qind për zonat rurale dhe 5.4 për qind në zonat urbane. Mohimi i ushqimit për të uriturit dhe ushqimi i tregjeve është një nga aspektet genocidale të globalizimit. Vendet nuk mund të sigurojnë që të varfrit dhe të uriturit të ushqehen sepse për këtë duhen ligje, politika, dhe përkushtime financiare që konsiderohen "proteksioniste"; krimi më i madh në regjimin e globalizimit.

Mohimi i ilaçeve për të sëmurët në mënyrë që kompanitë farmaceutike të mund të nxjerrin fitime është një tjetër aspekt i genocidit. Sipas marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë për Pasurinë Intelektuale të Lidhur me Tregtinë, vendet duhet të zbatojnë legjislacione në lidhje me patentat që garantojnë të drejta ekskluzive dhe monopolistike për industrinë farmaceutike dhe bioteknike. Kjo i ndalon vendet që të prodhojnë ilaçe të përgjithshme me kosto të ulët. Mjekimet e patentuara të HIV/AIDS kushtojnë 15.000 USD në vit, ndërsa mjekimet e përgjithshme të prodhuara në Indi e Brazil kushtojnë 250-300 USD në vit. Prandaj patentat janë literalisht duke grabitur jetën e viktimave të AIDS. Sidoqoftë, në sistemin botëror të globalizimit të diktuar nga tregtia, makutëria, dhe fitimet, dhënja e kurave me ilaçe jo shumë të kushtushme është e paligjshme. India, Brazili, dhe Afrika e Jugut janë çuar përpara Gjyqit të OBT-së (Mekanizmit për Zgjidhjen e Kontradiktave) sepse ata kanë ligje që lejojnë prodhimin e ilaçeve me kosto të ulët.

Në Gjyqin Botëror të Grave, ne deklarojmë se ligjet që detyrojnë një qeveri që tu mohojë qytetarëve të saj të drejtën e ushqimit dhe të drejtën e mjekimeve janë ligje genocidale. Globalizimi është një sistem i dhunshëm, i vendosur dhe i mbajtur nëpërmjet përdorimit të dhunës. Ndërsa tregtia ngrihet përmbi nevojat njerëzore, oreksi i pangopshëm i tregjeve botërore për burimet përmbushet duke ndezur luftra të reja mbi këto burime. Lufta për diamantet në Sierra Leone, ajo për naftë në Nigeri kanë vrarë me mijra gra e fëmijë.

Transferimi i burimeve nga njerëzit tek korporatat globale gjithashtu bën edhe më shumë shtete militaristë duke qënë se ata armatosen për shkak të interesave tregtarë, dhe nisin luftra ndaj shtetasve të tyre. Dhunë është përdorur nga qeveritë kundrejt njerëzve të tribuve ku nxirret Bauxiti në Orisa dhe Koel Karo, ku ndërtimi i një dige të madhe u ndalua. Por nuk janë vetëm burimet e parinovueshme si diamantet, nafta, dhe mineralet ato që korporatat globale duan të kenë të tyret. Ata duan të jenë pronarë të diversitetit dhe ujit tonë. Ata duan të transformojnë vetë materialin dhe bazën e jetës në pronë private. Të Drejtat e Pasurisë Intelektuale mbi farat dhe bimët, kafshët dhe gjenet njerëzore synojnë që ta transformojnë jetën në një pronë të korporatave.

Ndërsa mashtrojnë duke thënë se kanë "shpikur" forma të reja të jetës dhe organizma të gjalla, korporatat gjithashtu kërkojnë patenta mbi njohuri të marra në mënyrë piraterike nga Bota e Tretë. Njohuritë e nënave dhe gjysheve tona tani shprehen si shpikje të korporatave dhe shkencëtarëve perëndimorë. Përdorimi i Neem-it (Azarichtha Indica) si pesticid dhe fungicid u shpreh dhe u kërkua si një shpikje nga U.S.D.A. dhe W.R.Grace. India e sfidoi këtë kërkesë dhe e revokoi patentën. Farat dhe bima e Basmati-t janë deklaruar si shpikje të një korporate amerikane e quajtur Ricetec. Këto janë vetëm disa nga shembujt e piraterisë bioteknike që do të shpien tek situata absurde kur Bota e Tretë të paguaj për njohuri që është zhvilluar bashkarisht nga të gjithë.

Nga Gjyqi Botëror i Grave, ne deklarojmë se patentat mbi jetën dhe patentat e bazuara në piraterinë bioteknike janë të pamoralshme dhe të jashtëligjshme. Ato nuk duhen respektuar sepse ato dhunojnë principet universalë të respektit për jetën dhe integritetin e sistemeve të njohurisë kulturore.

Ne nuk do të jetojme sipas rregulloreve që po u vjedhin miliona njerëzve jetën dhe ilaçet e tyre, farat e tyre, bimët, dhe njohuritë, mjetet e jetesës dhe dinjitetin, dhe ushqimin e tyre. Ne nuk do të lejojmë makutërinë dhe dhunën që të trajtohen si të vetmet vlera që formojnë kulturat tona dhe jetët tona. Ne do të marrim përsëri jetët tona, ashtu siç kemi bërë gjithmonë. Ne e dimë se dhuna gjeneron dhunë, se frika sjell fikë, paqja buron paqe, dhe dashuria buron dashuri. Ne do ta

rikonstruktivisht botën si një vend i ndarjes së burimeve dhe përkujdesjes, jo si një vend tregu ku ndarja dhe kujdesi dhe mbrojtja konsiderohen si krime, dhe paqja e drejtësia janë të pamendueshme. Ne do të formojmë parime të reja universale nëpërmjet solidaritetit, dhe jo nëpërmjet hegjemonisë.

Botët e grave janë botë të bazuar mbi mbrojtjen e dinjitetit dhe vetë-respektimit tonë, mirëqenjes së fëmijëve tanë, të Tokës, të qenjeve të saj përbërse, të atyre që janë të uritur dhe të atyre që janë të sëmurë. Mbrojtja është shprehja më e mirë e njerëzimit. Ata që janë përpjekur të transformojnë “mbrojtjen” në një fjalë të ndyrë, krimi më i keq i tregut global, e shohin mbrojtjen e shëndetit, ushqimit, jetëve njerëzore si thirrje për sanksione tregtare dhe “ndëshkime” nga OBT-ja dhe Banka Botërore.

Të gjithë atyre që janë përpjekur ta kthejnë mbrojtjen e jetës në një krim, neve u themi, duke përdorur shprehjen e Arqipeshkvit Tutu: “Ju keni humbur tashmë. Ju duhet të largoheni në mënyrë që ne të mundemi të mbrojmë njëri-tjetrin, fëmijët tanë dhe jetën në këtë planet.” E ardhmja nuk u takon Tregtarëve të Vdekjes, i takon Mbrojtësve të Jetës.

Vandana Shiva, autorja e kësaj pjese, është Drejtore, Fondacioni Kërkimor për Shkencën, Teknologjinë, dhe Ekologjinë, New Dehli, Indi.